



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
AGJENCIA E MBIKËQYRJES POLICORE

Nr. 15/35 Prot.

Tiranë më 11/04/2024

V E N D I M

Nr. 22 Datë 11.04.2024

Trupa e Vlerësimit e Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, e përbërë nga:

Suela Bulku Kryesuese
Arben Sefaj Relator
Denisa Sina Anëtar

Në datën 07.04.2024, në Godinën e Ministrisë së Brendshme, salla e mbledhjeve, kati 1, asistuar nga anëtarja e sekretariatit teknik Znj. Lediana Azemaj, zhvilloi seancën dëgjimore publike për çështjen që i përket:

SUBJEKTIT TË VLERËSIMIT:

Z. **Altin Mehmet Qato**, me funksion Drejtor në Drejtorinë e Policisë Rrugore në Departamentin e Sigurisë Publike, pranë Drejtorisë Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

OBJEKTI:

Vlerësimi kalimtar i subjektit të vlerësimit.

BAZA LIGJORE:

Ligji Nr. 12/2018, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar.

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

Ligji nr. 49/2012, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative”.

Rregullore nr.197, datë 23.02.2023 “Për hapat procedural të unifikuar”.





Trupa e Vlerësimit e Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, pasi dëgjoi gjetjet bazuar në arsyetimin ligjor si dhe rekomandimin e relatorit të çështjes Z. Arben Sefaj, vlerësoi shpjegimet e subjektit të vlerësimit dhe analizoi provat shkresore të paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit, pasi dëgjoi subjektin e vlerësimit Z. Altin Mehmet Qato, i cili në seancë dëgjimore publike kërkoi konfirmimin e tij në detyrë, shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi duke u bazuar në të tre kriteret e vlerësimit, të pasurisë, të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, mbështetur në pikën 1, të nenit 4, të Ligjit Nr.12/2018, i ndryshuar.

VËREN:

Agjencia e Mbikëqyrjes Policore është institucioni që kryen procesin e vlerësimit kalimtar të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, bazuar në Ligjin nr.12/2018, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar.

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Sipas përcaktimeve të neneve 2, 4 dhe 6, të Ligjit nr. 12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar, shtetasi Altin Qato është subjekt i vlerësimit kalimtar nga Trupat e Vlerësimit të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, për shkak të funksionit të tij në datën e zhvillimit të shortit 05.04.2023, si Drejtor në Drejtorinë e Policisë Rrugore, në Departamentin e Sigurisë Publike, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.
2. Subjekti i vlerësimit, Z. Altin Qato iu nënshtroi procedurave të vlerësimit, duke u shortuar në shortin e zhvilluar 05.04.2023 nga Trupat e Vlerësimit në përputhje me Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm nr.7, datë 17.01.2023, “Për procedurat e hedhjes së shortit”.
3. Në zbatim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit, me vendimin Nr.1 datë 18.04.2023, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupës së vlerësimit e përbërë nga: Znj. Suela Bulku Kryesuese, Z. Arben Sefaj Relator dhe Znj. Denisa Sina Anëtare.
4. Trupa e Vlerësimit në përputhje me Ligjin nr.12/2018, i ndryshuar, si edhe në bazë të Rregullores nr.197, datë 23.02.2023, “Për hapat procedural të unifikuar”, me Vendimin Nr.1, datë, 18.04.2023 vendosi fillimin e hetimit kryesisht për subjektin e vlerësimit Z. Altin Qato.
5. Relatori i çështjes, nëpërmjet komunikimit elektronik zyrtar datë 18.04.2023, ka njoftuar subjektin e vlerësimit për fillimin e procesit të vlerësimit kalimtar dhe i është bërë e njohur përbërja e Trupës së Vlerësimit, duke i kërkuar subjektit të vlerësimit të deklarojë nëse është në kushtet e konfliktit të interesit me anëtarët e trupës së vlerësimit.
6. Subjekti i vlerësimit ka dorëzuar deklaratën për konfliktin e interesit në Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore me shkresën nr. *** datë 24.04.2023, duke shprehur se nuk është në kushtet e konfliktit të interesit me asnjë nga anëtarët e trupës së vlerësimit.
7. Relatori i çështjes në vijim ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 3, të nenit 25, të Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar, duke kryer një hetim të plotë mbi tre kriteret e vlerësimit kalimtar.

8. Për të realizuar procedurat e vlerësimit kalimtar të punonjësve, trupa e vlerësimit është bazuar në parimin e ligjshmërisë, të barazisë përpara ligjit dhe të proporcionalitetit, duke garantuar të drejtën e punonjësve për një proces të rregullt ligjor.
9. Me shkresën nr. *** prot., datë 12.04.2023, të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit me objekt “Dërgim i formularëve për subjektet e vlerësimit” në përgjigje të shkresës nr.*** prot., datë 05.04.2023, bashkëlidhur dërgon formularët e deklaramentit dhe dokumentacionit të administruar për subjektet e vlerësimit, ndër to edhe për subjektin e vlerësimit, Drejtues i Parë Altin Qato, me funksion Drejtor në Drejtorinë e Policisë Rrugore, në Departamentin e Sigurisë Publike, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.
10. Procesi i vlerësimit kalimtar të punonjësve bazuar në nenin 4, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar ka për objekt:
 - Vlerësimin e pasurisë,
 - Kontrollin e figurës,
 - Vlerësimin e aftësive profesionale.
11. Trupa e vlerësimit ka realizuar procesin e hetimit administrativ, bazuar në:
 - a. Ligji nr.12/2018, “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat” i ndryshuar,
 - b. Ligji nr.128/2021, “Për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore”,
 - c. Ligji nr. 40/2015, “Kodi i Procedurës Administrative”,
 - d. Ligji nr. 49/2012,“Për Gjykatën Administrative dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative”,
 - e. Ligji nr. 9367/2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike”,
 - f. Udhëzim Nr.7 datë 17.01.2023, i Ministrit të Brendshëm “Për procedurat dhe mënyrat e hedhjes së shortit për Trupat e Vlerësimit dhe subjektet e vlerësimit të ligjit Nr.12/2018, “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar”,
 - g. Udhëzimin e përbashkët të Ministrisë së Brendshme dhe ILDKPKI nr. 15, datë 27.01.2023, “Për miratimin e formularëve të deklaramentit të pasurisë për vlerësimin kalimtar dhe periodik, si edhe mënyrën e plotësimit të tyre nga subjektet e vlerësimit dhe personat e lidhur që mbartin detyrim për deklarimin e pasurisë në zbatim të ligjit nr. 12/2018, “Për vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme” i ndryshuar,
 - h. Rregulloren nr.197, datë 23.02.2023, “Për hapat procedural të unifikuar”,
 - i. Duke verifikuar dhe vlerësuar të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme dhe konkretisht deklaratat e dorëzuara nga vetë subjekti i vlerësimit në DPPSH që janë:
 -  *Deklarata e Pasurisë,*
 -  *Deklarata për Kontrollin e Figurës,*
 -  *Formulari i Aftësive Profesionale,*
 -  *Dokumentacioni bashkëlidhur deklaratave për të justifikuar deklaramentet,*
 - j. Provat shkresore/dokumente të administruara nga institucionet/organet publike dhe private në përputhje me Ligjin nr.12/2018, i ndryshuar,
 - k. Provat dhe shpjegimet me shkrim të subjektit të vlerësimit,

1. Ka marrë në konsideratë bashkëpunimin, gatishmërinë dhe sjelljen e subjektit gjatë procesit të vlerësimit.
12. Trupa e vlerësimit, me datë 16.02.2024, pasi dëgjoi relatorin, dhe krijoi bindjen se provat e administruara për kriterin e pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, kishin nivelin e provueshmërisë, si dhe pasi konstatoi se janë marrë të gjitha hapat e nevojshme për përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e vlerësimit Z. Altin Qato, me Vendimin Nr.4 datë 16.02.2024, vendosi:
 - a. Të mbyllë hetimin kryesisht për subjektin e vlerësimit Z. Altin Qato.
 - b. Të njoftojë me rrugë elektronike zyrtare subjektin për:
 - *Përfundimin e procedurave të hetimit kryesisht,*
 - *Rezultatet e hetimit të pasqyruara në relacionin paraparak për të tre komponentët, e vlerësimit pasuror, kontrollit të figurës dhe atij profesional.*
 - c. Të ftojë subjektin për t'u njohur me dosjen dhe provat e administruara nga Trupa Vlerësuese, në përputhje me nenin 50, të ligjit nr.12/2018, të ndryshuar, nenet 35-40 dhe 45-47, të Kodit të Procedurës Administrative, duke i dhënë kohë të arsyeshme prej 5 ditësh për t'u njohur me dosjen dhe për të paraqitur shpjegime.
13. Hetimi administrativ përfshiu edhe personat e lidhur apo persona të tjerë të lidhur në kuptim të nenit 3, pika 11, neni 5, i Ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funkcioneve Publike”, si dhe nenit 34, pika 1 e Ligjit nr.12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar.

II. SEANCA DËGJIMORE

14. Seanca dëgjimore për subjektin e vlerësimit Altin Qato , u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 56, të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar si dhe Kodin e Procedurave Administrative. Subjekti i vlerësimit nuk kishte zgjedhur mbrojtës ligjor. Gjatë seancës dëgjimore, pas fjalës së relatorit, subjekti i vlerësimit parashtrroi disa shpjegime lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe mbi procesin e vlerësimit në tërësi të kryer ndaj tij (të regjistruar në materialin audio në seancë dëgjimore). Në fund të seancës dëgjimore datë 07.03.2024, subjekti i vlerësimit Altin Qato, kërkoi konfirmimin në detyrë.

Trupa e vlerësimit shpalli vendimin më datën 12.04.2024, për subjektin e vlerësimit.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË VLERËSIMIT

15. Z. Altin Qato ka qenë korrekt dhe bashkëpunues gjatë procesit të vlerësimit, duke u përgjigjur brenda afatit të përcaktuar, sipas pikës 2, të nenit 48, të ligjit Nr.12/2018, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, të ndryshuar.

A. VLERËSIMI I PASURISË

16. Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e vlerësimit, në përputhje me kreun III, të ligjit nr.12/2018, të ndryshuar, “Vlerësimi i pasurisë”, dhe veçanërisht në nenin 31 të këtij ligji, ka

për objekt të vlerësimit deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e vlerësimit kalimtar dhe për personat e lidhur me të.

18. Në zbatim të nenit 32, pika 2, e ligjit nr.12/2018, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar, subjekti i vlerësimit Z. Altin Qato ka dorëzuar deklaratën e pasurisë në datën 10.03.2023. Formulari i Pasurisë ka nr. *** index 2023.
19. Procedurat e deklarimit të pasurisë kryhen sipas përcaktimeve të nenit 32, dhe nenit 33, ndërsa vlerësimi i pasurisë nga trupa e vlerësimit kryhet sipas përcaktimeve të nenit 34, të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.
20. Për të vërtetuar saktësinë e vlerësimit të pasurisë së deklaruar, saktësinë e burimeve financiare të deklaruara dhe mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet e deklaruara, si dhe evidentimin e rasteve të konfliktit të interesit, janë kryer verifikime në të gjitha institucionet apo personat juridike, publikë e privatë.
21. Gjithashtu Trupa e Vlerësimit ka mbajtur në konsideratë deklaratimet e dhëna nga subjekti për vërtetimet e të ardhurave për secilin vit kalendarik, të shoqëruara me dokumentacion zyrtar, raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së në zbatim të neneve 33/1 dhe 34 , shpjegimet e subjektit për burimin e të ardhurave, mbulimin e shpenzimeve dhe të detyrimeve financiare. Ka kontrolluar dhe krahasuar gjendjen pasurore dhe ndryshimet e saj në vite, burimin e krijimit, pagimin e detyrimeve financiare, të ardhurat dhe shpenzimet për subjektin e vlerësimit dhe personave të lidhur me të.
22. Bazuar në nenin 32, pika 1.1, të ligjit nr. 12/2018, “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjet e Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar, “Subjekti i vlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive në rastet e përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, nga viti 2008 dhe në vijim”.

Neni 1 citon; “Subjekti i vlerësimit dhe personat e lidhur me të deklarojnë çdo pasuri, të luajtshme apo të paluajtshme, të fituar, poseduar, përdorur apo tjetërsuar, nga data e fillimit të punës në institucionin e Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore deri në ditën e plotësimit të formularit të deklarimit të pasurisë”.

Trupa e vlerësimit për realizimin e procesit të vlerësimit të pasurisë administroi:

- *Deklaratën e pasurisë dhe dokumentacionin bashkëlidhur;*
- *Raportin e hollësishëm të përgatitur nga ILDKPKI;*
- *Provat shkresore/dokumente të vëna në dispozicion nga institucionet/organet publike dhe private në përputhje me ligjin nr.12/2018, i ndryshuar;*
- *Dokumentacionin e paraqitur në deklaratimet e subjektit, si edhe përgjigjet e pyetjeve të dërguara nëpërmjet postës elektronike;*

Hetimi administrativ konsistoi në:

- ✓ Verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve në lidhje me gjendjen pasurore të deklaruar nga subjekti i vlerësimit;
- ✓ Verifikimin e burimit/eve të krijimit të ardhurave dhe shpenzimeve të deklaruara si edhe në mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet financiare të ligjshme;
- ✓ Evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi apo në përdorim;

- ✓ Evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklarimeve të rreme si edhe evidentimit të rasteve të konfliktit të interesit.
23. Altin Qato është bërë subjekt deklarues pranë ILDKPKI në vitin 2003, me numër indeksi ***, dhe sipas deklarimit online me numër indeksi ***. Në zbatim të ligjit Nr. 9049, datë 10.04.2003 i ndryshuar dhe ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, ka dorëzuar ndër vite deklaratat e interesave private, dhe përveç këtyre bazuar në ligjin nr. 12/2018, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat” i ndryshuar, ka plotësuar edhe deklaratën e pasurisë për vlerësimin kalimtar me datë 10.03.2023.
24. Në zbatim të ligjit nr. 9049, dt.10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar dhe të ligjit nr. 9367, dt.07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, ka dorëzuar ndër vite deklaratat e interesave private, si më poshtë:
- Para fillimit të detyrës 2003,
 - Pas Largimit nga Funkzioni 2004,
 - Para fillimit të detyrës 2009,
 - Periodike/Vjetore 2009,
 - Periodike/Vjetore 2010,
 - Periodike/Vjetore 2011,
 - Pas Largimit nga Funkzioni 2012,
 - Periodike/Vjetore 2012,
 - Pas Largimit nga Funkzioni 2013,
 - Periodike/Vjetore 2013,
 - Periodike/Vjetore 2014,
 - Periodike/Vjetore 2015,
 - Periodike/Vjetore 2016,
 - Periodike/Vjetore 2017,
 - Periodike/Vjetore 2018,
 - Pas Largimit nga Funkzioni 2019,
 - Para fillimit të detyrës 2021,
 - Periodike/Vjetore 2021,
 - Periodike/Vjetore 2022.
25. Për një kontroll sa më të plotë të deklaratës së pasurisë të subjektit të vlerësimit Z. Altin Qato si edhe për të krahasuar Deklaratën e Pasurisë për vlerësimin kalimtar dhe dokumentacionin justifikues të dorëzuar nga subjekti janë bërë kërkesa nga ILDKPKI, me anë të korrespondencës nr. *** prot., datë 26.04.2023, pranë këtyre institucioneve:
- Banka e Shqipërisë.
 - Banka Raiffeisen sh.a.
 - Banka Kombëtare Tregtare sh.a.
 - Banka Intesa Sanpaolo sh.a.
 - Banka Tirana sh.a.
 - Banka e Bashkuar e Shqipërisë sh.a.

- Banka Procredit sh.a.
- Banka e Parë e Investimeve sh.a.
- Banka Amerikane e Investimeve sh.a.
- Banka Credins sh.a.
- Banka Union sh.a.
- Banka OTP Albania sh.a.
- Raiffeisen Leasing sh.a.
- Porsche Leasing sh.p.k.
- Albania Leasing sh.a
- Landeslease sh.a.
- RFZ Invest sh.a.
- Credins Invest sh.a.
- Unioni Financiar i Tiranës sh.a.
- AK - Invest sh.a.
- EASYPAY shpk
- Fondi BESA sh.a.
- Institucioni Financiar NOA sh.a.
- IUTECREDIT Albania sh.a.
- KREDO FINANCE shpk.
- ASHK.
- DPSHTRR.
- Qendra Kombëtare e Biznesit.
- DPT.
- ISSH.
- DPD.
- FSHU.
- 15-Shoqëria Rajonale UK.
- Vodafone Albania sh.a.
- One Albania sh.a.
- Albania Satelite Communications sh.p.k.
- ABISNET sh.a.
- DIGICOM sh.p.k.

26. Nga Trupa Vlerësuese pranë A.M.P është kërkuar informacion shtesë pranë institucioneve:

- Regjistrin Noterial Shqiptar,
- Raiffeisen Bank sh.a,
- Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit,
- Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë,
- Prokurorisë së Përgjithshme,
- SPAK.

27. **Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja:**

Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me ligjin nr. 9049, dt. 10.4.2003, "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", i ndryshuar, ligjin nr. 9367, dt. 07.04.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", i ndryshuar, në nenin 33/1, të ligjit nr. 12/2018 "Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat", i ndryshuar, si dhe në Kodin e Procedurave Administrative, bazuar në dokumentacionin e administruar, ILDKPKI me shkresën nr. *** prot., datë 31.07.2023, "Dërgohet akti i përfundimit të kontrollit të plotë të Deklaratës së Pasurisë për vlerësimin kalimtar të subjektit Altin Qato" konstatohet se

- a) deklarimi është i saktë, në përputhje me ligjin, me burimet e ligjshme financiare,
- b) nuk ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë,
- c) nuk është kryer fshehje të pasurisë,
- d) nuk është kryer deklarim i rremë,
- e) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.

28. Deklarimi i Pasurive:

Pasuria nr. 1.

- a. Shtëpi banimi me sipërfaqe 93.⁰⁰ m² me adresë Njësia Administrative Nr.***, rruga "****", Pallati ***, Apartamenti ***, Tiranë. Nr. i pasurisë 7/****, Vlera 4.500.000 lekë. Regjistruar me datë 26.10.2020 me proces legalizimi sipas vendimit nr. 1038, datë 14.10.2009 të KM. Burimi i krijimit të ardhurat financiare ndër vite. Zotëron: 100%. Apartamenti është i rivlerësuar me datë 29.06.2021 në shumën 11.066.400 lekë.

Bashkëlidhur deklaratës:

- ✓ Certifikatë për vërtetim pronësie në emër të z. Altin Qato. Apartament me sip. 93.⁰⁰ m² nr. pasurie 7/****, vol. **, fq. **, ZK. 8310, lëshuar në dt. 26.10.2020.
- ✓ Leje Legalizimi, nr. ***, dt. 27.06.2020, dhënë Altin Qato, për objektin ap. ***, kati i ***, në objektin e kombinuar 7 kate, nr. pasurie 7/****, ZK. 8310, sipërfaqe parcelë ndërtimore 352 m², sip. ndërtimi 93 m², numri i kateve mbi tokë 7. Titulli i pronësisë mbi tokën, vërtetuar me dokumentin "Miratuar me VKM nr. 1038, dt. 14.10.2009".
- ✓ Akt Verifikimi nga Drejtoria Vendore Tirana-Veri, ku konfirmohet se në seksionin "D", është shënuar rivlerësimi i pasurisë me nr. 7/****, vol. ***, fq.***, ZK.8310. Bashkëlidhur: Kartela e Pasurisë së Paluajtshme nr. 7/**** ZK. 8310, në emër të Altin Qato, me përshkrimin e veçantë "Leje Legalizimi" nr. ***, dt. 27.06.2020, sipërfaqja takuese e shkallëve 5 m² dhe në seksionin "D", me shënimin "rivlerësuar" në dt. 14.06.2021, në vlerën 11.066.400 lekë.
- ✓ Deklaratë Noteriale nr. *** rep, dhe nr.*** kol, dt. 09.01.2019, nga A.C, ku deklarohet se ka marrë pjesë në ndërtimin e një objekti me disa kate, në vitin 2005, i ndodhur në Laprakë, Tiranë dhe në muajin mars të vitit 2007, pasi ka përfunduar ndërtimi i objektit, apartamentin e mobiluar pjesërisht, me sip. 100 m², të cilin e ka përfutuar nga pjesëmarrja në ndërtim, ja ka shitur z. Altin Qato, në vlerën totale 4.500.000 lekë, nga të cilat 3.500.000 lekë apartamenti dhe 1.000.000 lekë mobiliet që ka patur apartamenti. Likuidimi i shumës 4.500.000 lekë është bërë nga muaji mars 2007 deri në dhjetor 2008. Objekti është futur në proces Legalizimi dhe vetdeklarimi i procedurës për legalizim ishte bërë në emër dhe për llogari të Altin Qato.

E gjithë procedura për legalizimin e apartamentit dhe dalja e Lejes së Legalizimit do të jenë në emër të Altin Qato.

Bashkëlidhur:

- ✓ Vetdeklarimi për legalizimin e objektit shtëpi banimi në adresën "****", me vit ndërtimi 1993, sip. e zënë 490 m² dhe sipërfaqe ndërtimi 240 m². Numri i kateve mbi tokë 5. Foto të ndërtimit 5 katesh.
 - ✓ Konfirmim i gjendjes civile, ku vërtetohet ndarja nga trangu familjar i Altin Qato, me aktin nr. ****, dt. 02.04.2008.
29. ASHK Drejtoria e Përgjithshme, me shkresën nr. **** prot., datë 12.06.2023, konfirmon se Altin Qato, rezulton i pajisur me Vendim Legalizimi nr. ****, dt. 27.06.2020, ap. ****, kati ****, në objekt të kombinuar 7 kate, njësia Adm. ****, Tiranë.
30. ASHK, Drejtoria Vendore Tirana Veri, me shkresën nr. **** prot., dt. 03.07.2023, konfirmon se në emër të Altin Qato, rezulton e regjistruar pasuria me nr. 7/****, vol. ****, fq.****, Zk.8310.

Bashkëlidhur:

- Kartela e pasurisë së paluajtshme nr. 7/****, vol. ****, fq.****, zk. 8310, e llojit apartament me sip. 93 m², në emër të Altin Qato, regjistruar në dt. 26.10.2020, me Leje Legalizimi, nr. ****, dt. 27.06.2020. Në seksionin "D" ka shënimin "Pasuria rivlerësohet në shumën 11.066.400 lekë".
 - Leje Legalizimi nr. ****, dt. 27.06.2020, për Altin Qato, për objektin Ap.****, kati i ****, në objektin e kombinuar 7 kate, nr. pasurie 7/****, zk. 8310, sip. parcelë ndërtimore 352 m², sip. ndërtimi 93 m², numri i kateve mbi tokë 7. Titulli i pronësisë mbi tokën vërtetuar me dokumentin "Miratuar me VKM nr. 1038 dt. 14.10.2009". Bashkëlidhur: Planimetria e katit të 4, për apartamentin me sip. banimi 93 m² dhe sip. të përbashkët 5 m². Genplan, Lista emërore dhe tabela llogaritëse e sipërfaqeve, ku konfirmohet se Altin Qato është banor i katit të 4-t, në apartamentin me nr. pasurie 7/****, me sip. banimi 93 m² dhe sip. të përbashkët 5 m². Formular Vetdeklarimi nr. **** prot., dt. 13.11.2006, në emër të T.H, për shtëpi banimi në Rrugën "****", ndërtuar në vitin 1993, sip. e zënë 490 m² dhe sip. ndërtimi 240 m². Foto të objektit 5 katesh në ndërtim. Certificate e përbërjes familjare të T.H, në dt. 15.06.2006.
 - Deklaratë Noteriale nr. **** rep, nr. **** kol, dt. 24.06.2020, e të gjithë banorëve të pallatit, ndër ta edhe Altin Qato, ku deklarohet se objekti 7 kate + bodrum, në Njësinë Administrative nr. ****, është ndërtuar me kontributin e vetë banorëve dhe në këto kushte janë dakord që të vijojnë me procedurat e legalizimit dhe hipotekimit të objektit në emrin e tyre (për të gjithë banorët)
 - Lista e banorëve të pallatit, ku është shënuar "Vetdeklarues T.H".
 - Planimetria e apartamentit në pronësi të Altin Qato, me adresë Laprakë, Rr. "****".
31. Në dosje është administruar: Deklaratë nr. **** rep, dhe nr.**** kol, datë 30.06.2023 e M.Qato, L.Qato, E.Qato, Altin Qato, ku deklarohet se: "Në muajin Mars 2002 familja jonë është shpërngulur nga Berati dhe jemi vendosur me banim në qytetin e Tiranës, pasi në këtë kohë kryefamiljari ynë, i quajtur M.Q. ka blerë një apartament banimi në Tiranë, me adrese në Rr. "****", si dhe një dyqan po në të njëjtin pallat, me sip. 200 m², me 1/2 pjesë takuese. Dyqani prej vitit 2004 e deri më sot është dhënë me qira. Të ardhurat për blerjen e kësaj prone janë të ardhurat e fituara nga banesa që familja jonë ka patur me parë në Berat. Në datën 02.04.2008 me Aktin Nr.****, Altini është ndarë nga trangu familjar. Pas ndarjes nga trangu familjar Altini së bashku me bashkëshorten dhe fëmijët e tyre kanë jetuar në banesë më vehte, të cilën e ka

blerë në vitin 2007, e cila është paguar gjatë periudhës 2007-2008. Duke qenë se deri më 02.04.2008 kemi qenë në një trung familjar, si dhe kemi pasur ekonomi familjare të përbashkët, të ardhurat për blerjen e banesës së Altinit janë përfituar nga kursimet tona të përbashkëta, si dhe nga të ardhurat e përfituara nga qiraja e dyqanit që kemi qenë në një trung familjar”.

32. Me inventarin nr. extra prot., datë 03.07.2023 depozituar në ILDKPKI, subjekti ka dhënë sqarime me shkrim, ku ka deklaruar se: Si burim për krijimin e apartamentit, kanë shërbyer të ardhurat e familjes, ku futen, të ardhurat e tij, të bashkëshortes, si dhe të prindërve të tij dhe vëllait, duke qenë se deri në dt. 02.04.2008 (datë në të cilën me aktin nr. ***, është ndarë nga trungu familjar), kanë pasur të njëjtën ekonomi familjare. Në vitin 2002, babai i subjektit me kontratën e Shitjes nr. *** rep. dhe nr. *** kol. datë 05.03.2002 ka blerë në Tiranë apartamentin 2+1 me sip. 100 m² ku banon aktualisht (ku ka banuar edhe subjekti deri në vitin 2008), me vlerë 1.900.000 lekë dhe një dyqan 200 m² sipas kontratës së shitjes pasurie të paluajtshme nr. *** rep. dhe *** kol. datë 05.03.2002 me vlerë 1.900.000 lekë, i cili është bashkëpronar me 50% dhe shuma e paguar prej tij ka qenë 950.000 lekë. Të ardhurat për blerjen e këtyre aseteve (shtëpisë dhe dyqanit), i ka përfituar nga shitja e banesës dhe një garazhi, që familja e tyre ka patur në Berat dhe janë shitur në vlerën 3.500.000 lekë, nga të cilat 2.800.000 lekë apartamenti, së bashku me garazhin dhe 700.000 lekë mobilimi. Apartamenti dhe garazhi ishin blerë në vitin 1998, nga babai i subjektit M.Q, në shumën 2.800.000 lekë. Shitja e tyre ka shërbyer si zanafillë që familja e tyre të transferohej në Tiranë, si dhe një pjesë e këtyre të ardhurave të përfituara nga shitja të përdorej për blerjen e dyqanit, i cili ka ndihmuar familjen për të shtuar të ardhurat financiare ndër vite. Pas ndarjes nga trungu familjar, subjekti dhe familja e tij kanë jetuar në banesën e blerë në vitin 2007, të cilën e kanë paguar gjatë periudhës 2007 - 2008. Të ardhurat për blerjen e banesës janë përfituar nga kursimet e tij dhe të b/shortes, nga kursimet e prindërve dhe vëllait pas vitit 1998, si dhe të ardhurat e përfituara nga dyqani i dhënë me qira. Subjekti ka sqaruar se: ka përmendur të ardhurat pas vitit 1998 - 2008, pasi investimi familjar për banesë është në vitin 1998, në qytetin e Beratit, ndërsa banesa në Tiranë së bashku me dyqanin janë blerë nga shitja e banesës dhe garazhit. Prindërit e subjektit janë me profesionin e mësuesit dhe aktualisht janë në pension. Kurse vëllai i subjektit është dhe ushtron profesionin mjekut që nga viti 2003. Dyqani me sipërfaqe prej 200 m² nga viti 2004 e në vazhdim është dhënë me qira por kontratë qereje ekziston nga 17.10.2007, shuma e përfituar rreth 250.000 lekë. Pagesa për blerjen e apartamentit është bërë në cash nga kursimet familjare por edhe nga tërheqjet që janë bërë në Tirana Bank, në vitet 2007-2008. Subjekti deklaroi se shuma e paguar në vitin 2008 është 9.000 euro. Fatura pagesash nuk disponon.

❖ **Hetimi i kryer nga Trupa Vlerësuese pranë AMP:**

33. Në vitin 2002 babai i subjektit me kontratën e Shitjes nr.*** rep. dhe nr.*** kol. datë 05.03.2002 ka blerë në Tiranë apartamentin 2+1 me sip.100 m² ku banon aktualisht (ku ka banuar edhe subjekti deri në vitin 2008), me vlerë 1.900.000 lekë. Gjithashtu z. M.Q së bashku me z. E.B kanë blerë me kontratë Shitje Pasuri të Paluajtshme nr. *** rep. dhe nr. *** kol. datë 05.03.2002, një dyqan nga një ndërtesë 5 kateshe, kati përdhe, në rrugën “****” zk. nr. 8310 nr. Pasurisë 7/***, me sipërfaqe 200 m² me vlerë 1.900.000 lekë. Të ardhurat për blerjen e këtyre aseteve (shtëpisë dhe dyqanit), i ka përfituar nga shitja e banesës dhe një garazhi, që familja e tyre ka patur në Berat dhe janë shitur në vlerën 3.500.000

lekë, nga të cilat 2.800.000 lekë apartamenti, së bashku me garazhin dhe 700.000 lekë mobilimi. Apartamenti dhe garazhi ishin blerë në vitin 1998, nga babai i subjektit M.Q, në shumën 2.800.000 lekë.

Me kontratën e qerasë nr. *** rep. dhe nr. *** kol. datë 17.10.2007 me një afat 10 vjeçar qiradhënësit M.Q dhe E.B i kanë dhënë objektin me qira qiramarrësit Shoqërisë “****” shpk me seli në Tiranë kundrejt vlerës 150.000 lekë në muaj. Nga të cilët, shuma e përgjithshme e çmimit kontraktor 50.000 lekë do i marrë z. M.Q dhe 100.000 lekë z. E.B. Shuma gjithsej e përfituar për periudhën nga 17.10.2007 deri më 02.04.2008 është rreth 250.000 lekë.

34. Për sa i përket shumës prej 700.000 lekë dhënë për mobilimin e apartamentit të shitur, z. E.Z. në deklaratën e tij nr.*** rep. dhe nr. *** kol. datë 10.01.2019 deklaroi se: *“Kam blerë një apartament me sipërfaqe 118 m² në katin e 5 që ka ndërtuar “****” shpk në qytetin e Beratit dhe një garazh me sip. 28.7 m² në katin përdhe të këtij pallati gjë që vërtetohet sipas kontratës shitje e pasurisë së paluajtshme nr. *** rep. dhe nr. *** kol. datë 08.08.2007”, “Këtë apartament dhe garazh në vitin 1998 e ka blerë nga firma “****” shpk, z. M.Q. i cili ka banuar në këtë apartament deri sa i bleva unë.”*
35. Z. E.A deklaroi se të gjitha orenditë elektroshtëpiake, mobiliet si edhe të gjitha shpenzimet që kishte bërë për rregullimin e këtyre shtëpive ai bleva unë z. M.Q, kundrejt shumës prej 700.000 lekë me të cilin u likuidova menjëherë dhe hyra në banesën e mësipërme.
36. Trupa Vlerësuese vlerëson se: referuar deklaratës noteriale të bërë nga z. E.A nr. *** rep. dhe nr. *** kol. datë 10.01.2019 rezultoi se shuma prej 700.000 lekë referuar kontratës shitje e pasurisë së paluajtshme nr. *** rep. dhe nr. *** kol. datë 08.08.2007 i është dhënë babait të subjektit të vlerësimit nga z. E.A. në vitin 2007.
- Nisur nga këto rrethana deklarata nr. *** rep. dhe nr. *** kol. datë 10.01.2019 në shumën prej 700.000 lekë për çmimin e orendive dhe pajisjet elektroshtëpiake, si edhe rregullimet e ndryshme të bërë në banesë merret në konsideratë dhe si e tillë përfshihet në tabelën e rezultatit financiar të hartuar nga Trupa Vlerësuese.

❖ **Konkluzion i Trupës Vlerësuese:**

✓ **Shuma prej 700.000 lekë dhënë nga z. E.A, për mobilimin dhe pajisjet elektroshtëpiake, përfshihet në tabelën e rezultatit financiar të hartuar nga Trupa Vlerësuese.**

37. Subjekti i vlerësimit ka deklaruar se gjatë vitit 1998-1999-2000 nga puna në Policinë e Shtetit, ka përfituar nga Taksa e Solidaritetit, të cilën nuk e ka deklaruar në formularët e deklarimit të pasurisë pasi kjo shumë nuk ka qenë në borderotë e pagave dhe nuk pasqyrohet në vërtetimet e pagave të lëshuara nga sektorët e financave të institucioneve ku ka punuar subjekti i vlerësimit.

Subjekti në deklaratimet shtesë ka paraqitur disa urdhëra të Ministrit të Rendit Publik, ku përcaktohet masa e shpërblimit që përfitohet bazuar në nivelin e N/Oficer e polic si edhe Oficerë, për periudhën nga 01.05.1999 deri më 31.12.2000 kur ka qenë me detyrë në Komisaratin e Policisë Skrapar, Krujë etj., Masa e shpërblimit ka qenë afërsisht rreth 240.000 lekë.

Urdhër nr.***, dt. 15.2.1999, nga Ministri i Rendit Publik, për caktimin e masës së shpërblimit që do të përfitohet nga taksa e solidaritetit.

- Urdhër nr.***, dt. 15.03.1999, për ndryshim në Urdhërin nr.***, dt. 15.02.1999.

- Urdhër nr.***, dt. 15.07.1999, për ndryshim në Urdhërin nr.***, dt. 15.02.1999.
- Urdhër nr.***, dt. 14.08.1999, për ndryshim në Urdhërin nr.***, dt. 15.02.1999.
- Urdhër nr.***, dt. 15.11.1999, për ndryshim në Urdhërin nr.***, dt. 15.02.1999.
- Urdhër nr.***, dt.30.12.1999, për ndryshim në Urdhërin nr.***, dt. 15.02.1999.
- Urdhër nr.*** deri në *** të vitit 2000, nga Ministri i Rendit Publik, për përcaktimin e nivelit të shpërblimit nga taksa e solidaritetit, për muajt janar - dhjetor 2000.

❖ **Hetimi i kryer nga Trupa Vlerësuese pranë AMP:**

38. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e subjektit të cilët janë Urdhërat e Ministrisë të Rendit Publik, Drejtoria e Personel Organizimit, sipas niveleve përcaktohet edhe shpërblimi mujor. Meqenëse nuk ekziston një shifër e saktë e dalë nga sektorët e financës ku është dhënë shpërblimi Trupa Vlerësuese vlerëson se: Në dosjen e subjektit gjenden rreth 16 urdhëra të Ministrisë të Rendit Publik ku në periudha të ndryshme përcaktohet masa të ndryshme të shpërblimit mujor që do të përfitohet nga Taksa e Solidaritetit. Nisur nga kjo bazuar në kategorizimin e funksioneve organike sipas niveleve të miratuar me Urdhërin Nr.***, datë 26.11.1998 shuma e përfituar nga subjekti i vlerësimit për periudhën nga 01.05.1999 deri më 31.12.1999 është në masën rreth 82.144 lekë, (10.268 lekë x 8 muaj = 82.144 lekë). Kurse për periudhën nga 01.01.2000 deri më 31.12.2000 është në masën rreth 123.216 lekë, (10.268 lekë x 12 muaj = 123.216 lekë). Gjithsej 205.360 lekë (*pasqyruar në tabelën e rezultatit financiar*) Masa e shpërblimit mujor mesatar është përllëgarit në rreth 10.268 lekë në muaj. (*shuma sipas urdhërave që disponohen në dosje është 164.300 lekë / 16 urdhëra = 10.268 lekë në muaj, niveli i përcaktuar është niveli III*).
39. Z. Qato ka filluar punë për herë të parë në Policinë e Shtetit më 01.08.1993 me detyrë Shef i Policisë Kriminale në Komisaratin e Policisë Skrapar. Deri më datë 22.05.2004 ka vazhduar me detyra të ndryshme në Policinë e Shtetit dhe për këtë fakt subjekti ka paraqitur gjithë dokumentacionin financiar që justifikon të ardhurat e tij të përfituara nga punësimi. Pas datës 22.05.2004, Z. Altin Qato me Urdhërin Nr.***, datë 22.05.2004 “Për Përrjashtim nga strukturat e Policisë së Shtetit”, Ministri i Rendit Publik urdhëron që N/Komisar Altin Qato, të përjashtohet nga strukturat e Policisë së Shtetit me motivacion “Për shkelje të betimit”. Me datë 26.09.2008 subjekti është rikthyer në strukturat e policisë së Shtetit ku vazhdon edhe sot.
40. Në statementin e Raiffeisen Bank specifikohet kalimi në vitin 2006 i pagës së 12 muajve me vlerë 666.583 lekë të përfituara nga Vendimi nr. *** Akti “Për lëshimin e Urdhërit të ekzekutimit”, nga Gjykata e rrethit gjyqësor Tiranë.

❖ **Hetimi i kryer nga Trupa Vlerësuese pranë AMP:**

Trupa Vlerësuese pasi administroi dokumentacionin në dosjen e subjektit si edhe bazuar në vetëdeklarimin e subjektit të vlerësimit vëren se Z. Altin Qato ka filluar punë për herë të parë më 01.08.1993 me detyrë Shef i Policisë Kriminale në Komisaratin e Policisë Skrapar, duke vazhduar në disa Komisariate të Policisë së Shtetit deri më 22.05.2004, ku me urdhër Nr.*** datë 22.05.2004 “Për Përrjashtim nga strukturat e Policisë së Shtetit” Ministri i Rendit Publik Urdhëron që, N/Komisar Altin Qato, të përjashtohet nga strukturat e Policisë së Shtetit me motivacion “Për shkelje të betimit”.

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë Nr.*** i Regj. Themeltar dhe Nr. *** i Vendimit (***), Vendosi lënien në fuqi të Vendimit Nr. ***, datë 28.06.2006, të Gjykatës së Apelit Tiranë, e cila vendosi ndryshimin e vendimit nr. ***, datë 20.10.2005 të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, “Anulimin e urdhërit të Ministrit të Rendit Publik nr. *** datë 22.05.2004 dhe pagimin e dëmshpërblimit në masën e 12 pagave mujore”.

Trupa Vlerësuese arrin në konkluzionin se:

✓ **Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e administruar gjatë hetimit administrativ.**

41. Gjatë viteve Janar 2005 deri Shkurt 2007 subjekti në formularin e vetëdeklarimit deklaroi se është paguar si menaxher shitjesh dhe furnizimi materialesh, *pa dokumentacion*, nga firma “****” shpk me NIPT: *** në formën e honorarëve një shumë rreth 4.000.000 lekë.

Bashkëlidhur vërtetimi i lëshuar nga subjekti në fjalë i datës 15.06.2008 ku vërtetoi se z. Altin Qato për vitet 2005-2006-2007 ka punuar si asistent i jashtëm për furnizimin me bazë materiale si edhe menaxhimin e shitjeve të apartamenteve në shoqërinë “****” shpk. Shuma totale 32.150 euro.

42. Gjatë pyetësorit subjekti deklaroi se përgjatë viteve 2005-2006-2007 është paguar në formën e honorarëve nga shoqëria “****”, shpk shuma totale në harkun e tre viteve prej 32.000 euro. Si material shtesë subjekti paraqet edhe disa mandate pagesash në shumën prej 32.150 euro. Gjithashtu po në materialin shtesë të pyetësorit janë vënë në dispozicion të trupës edhe disa mandat arkëtime ku vërtetoi se janë lidhur disa marrëveshje bashkëpunimi si edhe shumat që janë arkëtuar si rezultat i ndikimit të z. Qato si menaxher shitjes dhe furnizimi materialesh. Subjekti ka paraqitur edhe disa mandate pagesa të lëshuara nga kompania “****” shpk, pagesa të cilat janë për subjektin e vlerësimit.

➤ **Hetimi i kryer nga Trupa Vlerësuese pranë AMP:**

43. Trupa Vlerësuese pasi administroi dokumentacionin në dosje si edhe bazuar në vetëdeklarimin e subjekti të vlerësimit vëren se Z. Altin Qato për vitet 2005-2006-2007 ka punuar si menaxher shitjesh në kompaninë “****” shpk dhe ka përfituar të ardhura në masën rreth 4.000.000 lekë, pa dokumentacion. Në pyetësorin shtesë deklaroi se ka përfituar një shumë rreth 32.000 euro. Në dokumentacionin shoqëruar të paraqitur nga subjekti gjatë pyetësorit shtesë, mandatë pagesat në total japin shumën prej 32.150 euro. Nga shqyrtimit i dokumentacionit të disponueshëm në dosje dhe kryesisht të mandatë pagesave që shoqëria “****” shpk, i ka likuiduar subjektit të vlerësimit rezultoi se: Subjekti në formularin e deklarimit deklaroi se ka punuar në këtë shoqëri nga janar 2005 deri në Shkurt 2007, nga verifikimi i disa mandat pagesave që shoqëria i ka bërë subjektit të vlerësimit rezultoi se ato fillojnë kryesisht rreth muajit Mars 2006 dhe vazhdojnë deri më nëntor 2008. Mandati nr. *** datë 05.11.2008 përkon edhe pas periudhës së punësimit të tij në Policinë e Shtetit të deklaruar nga vetë subjekti me datë 26.09.2008, (data e riparimit në polici)

Gjithashtu nga shqyrtimit i dokumentacionit që gjenden në dosje disa prej tyre (mandateve) janë të periudhave mbas shkurtit 2007 dhe disa të vitit 2008, periudhë të cilën subjekti deklaroi se nuk ka qenë në marrëdhënie pune me këtë subjekt.

Në ligjin Nr. 8438, Datë 28.12.1998 për “**Tatimin mbi të Ardhurat** ” i ndryshuar kreu IV, “**Tatimi i Mbajtur në Burimin e të Ardhurave**” neni 33; “**Mbajtja në burim e tatimit mbi të ardhurat**”: Të gjithë personat rezidentë në Republikën e Shqipërisë, organet e qeverisjes qendrore e vendore, organizatat jofitimprurëse dhe çdo subjekt tjetër, i njohur nga legjislacioni në fuqi, janë të detyruar të mbajnë tatimin në burim në masën **15 për qind** nga shuma bruto e pagesave të mëposhtme, që lindin nga një burim në Republikën e Shqipërisë, pika “e” pagesat për shërbimet teknike, **shërbimet e menaxhimit**, shërbimet financiare dhe ato të sigurimit; Lidhur me këtë konstatim, Trupa e Vlerësimit me e-mailin zyrtar të datës 27.09.2023 i është drejtuar subjektit të vlerësimit të japë shpjegime dhe të sjelli fakte që të vërtetojë të kundërtën e gjetjeve të Trupës Vlerësuese.

Në kthim përgjigjen e tij me e-mailin e datës 06.10.2023 protokolluar me tonën nr.*** prot., datë 09.10.2023, subjekti shpjegon se: “Gjatë viteve 2005-2006-2007 jam paguar në formën e honorarëve nga Shoqëria “***” sh.p.k. (bashkëlidhur në dosje ndodhet vërtetimi). Në këtë periudhë kam qenë i papunësuar në kuptim të formalizmit të një akti punësimi, dhe nga shoqëria “***” sh.p.k. mu ofrua që ti ndihmoja në menaxhimin e shitjeve të apartamenteve si dhe në blerjen e materialeve për ndërtim. Si shpërblim për këtë punë jam shpërblyer nga kjo shoqëri në harkun e tre viteve afërsisht në shumën e 32.000 euro”.

Përsa kërkohet nga ana juaj sqaroj se, bëhet fjalë për periudhë në të cilën unë kam qenë i larguar nga Policia e Shtetit dhe kam qenë në proces gjyqësor për rikthim në strukturat e Policisë së Shtetit. Nga administratorët e shoqërisë “***” sh.p.k. (lidhje shoqërore të mija), më është kërkuar që të ingranohesha në këtë shoqëri deri sa të përfundoja procesin gjyqësor dhe të rikthehesha në strukturat policore, me të drejtën time që buron nga Kushtetuta, për të vijuar një jetesë personale dhe familjare (duke siguruar të ardhura).

Për kontributin që kam dhënë, jam paguar nga shoqëria “***” shpk sipas shumës së sipërpërmendur për të gjithë periudhën e angazhimit tim pranë kësaj shoqërie në formën e honorarëve. Më lejoni të sqaroj gjithashtu se sipas ligjit mbi tatimin mbi të ardhurat, i cili thotë se punëdhënësi është i vetmi agjent i mbledhjes dhe pages të TAP. Sipas nenit 10 të tatimit mbi të ardhurat: “Çdo punëdhënësi, që paguan një page a shpërblim të parashikuar në gërmën “a” të nenit 8, të këtij ligji, mban tatimin mbi të ardhurat personale, në përputhje me paragrafin e parë të nenit 9, të këtij ligji dhe e derdh tatimin e mbajtur në favor të organeve tatimore jo më vonë se data 20 e muajit pasardhës. Në këto kushte, duke kërkuar mirëkuptimin tuaj objektiv, nuk disponoj asnjë dokument të pagesës së tatimit në burim për këtë shumë, pasi në vlerësimin tim ka qenë detyrim i punëdhënësit tatimi mbi fitim si dhe ruajtja e dokumentacionit për këtë qëllim.

Përsa i përket mandat pagesave të vitit 2008 si dhe asaj me nr.***, datë 05.11.2008, subjekti sqaron se: kanë qenë detyrime të prapambetura të cilat shoqëria “***” sh.p.k., nuk ka patur mundësi financiare të më paguante në periudhën 2005-2007 dhe më janë dhënë në vitin 2008, kohë në të cilën shoqëria ka patur mundësitë e veta financiare të përmbylljes së detyrimit të njohur nga ana e saj ndaj meje. Por theksoj që këto të ardhura i përkasin periudhës kur kam qenë i punësuar pranë shoqërisë “***” sh.pk..

44. Nisur nga faktet e mësipërme Trupa Vlerësuese argumenton se të ardhurat e përfituara nga “shërbimet e menaxhimit” të apartamenteve shuma prej 32.000 euro e përfituar, pa dokumentacion, në bazë të nenit 33, të ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998, i ndryshuar që të

përfshihej në analizën financiare të subjektit duhej të ishte e justifikuar me dokumentacion dhe e tatuar në masën prej 15%.

- ✓ Nisur nga ky konstatim Trupa Vlerësuese, vlerëson se shumën prej 32.000 euro (ose 4.000.000 lekë) nuk e përfshin në tabelën e rezultatit financiar.

45. Në dokumentacionin shoqërues të deklaratës së pasurisë, por e pa shprehur në formularët e vetëdeklarimit të pasurisë, subjekti i vlerësimit z. Altin Qato në nxjerrjen e llogarisë së datës 18.04.2018 rezulton se ka marrë një hua në shumën prej 19.000 euro nga shtetasi R.R. me datë 31.10.2005, shumë e cila është përdorur si garanci bankare për aplikimin për një vizë në Mbretërinë e Bashkuar. Me datë 20.12.2005 pas marrjes së vizës kjo shumë i është kthyer z. R.R, kjo sipas Deklaratës Noteriale nr. *** rep. dhe nr. *** kol. e përpiluar me datë 30.06.2023. Deklaruesi R.R deklaron se me datë 31.10.2005, i kam dhënë hua shumën *cash* prej 19.000 euro shtetasit Altin Qato të cilit i duhej për ta depozituar në bankë si garanci financiare pasi do të aplikonte për vizë në Mbretërinë e Bashkuar.

Vlera financiare prej 19.000 euro më është kthyer po *cash* nga z. Qato me datë 20.12.2005. Deklaruesi R.R deklaron se vlera financiare e dhënë hua është përfituar nga biznesi i tij “****” sh.p.k., me Nipt. “****” e krijuar që nga viti 1994. Bashkangjitur edhe certifikata e regjistrimit në organet tatimore si edhe viza për në Mbretërinë e Bashkuar e përfituar nga aplikanti subjekt vlerësimi.

➤ **Hetimi i kryer nga Trupa Vlerësuese pranë AMP:**

46. Trupa Vlerësuese pranë AMP pasi administroi dokumentacionin në dosje si edhe deklaratimet e subjektit bazuar edhe në përgjigjet e pyetësorit shtesë vëren se me datë 31.10.2005 subjekti ka marrë një hua nga z. R.R që është përdorur si garanci bankare për një aplikim që është bërë për vizë në Mbretërinë e Bashkuar, shumë e cila është kryer më datë 20.12.2005 kjo edhe sipas deklaratës së z. R.R nr. *** rep. dhe nr. *** kol. datë 30.06.2023 që e vërteton një fakt të tillë. Tirana Bank me shkresën nr. *** prot., datë 12.05.2023, konfirmon llogari rrjedhëse në emër të Altin Qato nga ku konfirmohet depozitimi i shumës 19.000 euro, në datë 31.10.2005 dhe tërheqja e saj me datë 20.12.2005.

Sipas deklaratimit të vetë z. R.R, vlera financiare e dhënë hua është përfituar nga biznesi i tij “****” sh.p.k. me Nipt : ***, e krijuar në vitin 1994. Për këtë fakt z. R.R ka nënshkruar edhe një deklaratë noteriale me nr. *** rep. dhe nr.*** kol. datë 30.06.2023 ku deklaron se i ka dhënë z. Altin Qato një hua financiare prej 19.000 euro *cash*.

Kjo vlerë i duhesh z. Qato, si garanci financiare për aplikim për vizë në Mbretërinë e Bashkuar. Shumë e cila i është kryer me datë 20.12.2005.

Të dy veprimet si depozitimi ashtu edhe tërheqja e shumës prej 19.000 euro, konfirmohet nga Tirana Bank sipas veprimit (printimit) të datës 18.04.2018.

- ✓ **Trupa vlerësuese arrin në konkluzionin se subjekti i vlerësimit ka bërë deklaratim të saktë dhe në përputhje me dokumentacionin shoqërues në dosje.**

47. Tirana Bank me shkresën nr. *** prot., datë 12.05.2023, konfirmon llogari rrjedhëse në emër të Altin Qato. Konfirmohet kreditimi i shumës 8.500 GBP në datë 29.05.2008 dhe i shumës 10.000 GBP, në datë 03.06.2008. Shuma të tërhequra me datë 11.07.2008 nga Altin Qato. Gjithashtu konfirmohet edhe llogari në monedhën Euro, në të cilën është transferuar shuma prej 12.314 Euro, në datë 09.07.2008 nga E.B, shumë e tërhequr në datë 21.07.2008.

48. Me vërtetimin e datës 18.04.2018 (printim) subjekti vlerësimit deklaroi se me datë 29.05.2008 janë transferuar nga shtetasi K.M dtl. 09.05.1965 një shumë prej 8.500 paund. Më datë 03.06.2008 po nga ky shtetas janë transferuar shuma prej 10.000 paund. Të dyja këto pagesa janë bërë me transfertë shtetasit Altin Qato në llogarinë e tij në Tirana Bank në nr. e llogarisë 0100***

49. Vërtetim nga shoqëria e kontabilitetit “****”, dt. 22.06.2023, (në gjuhën angleze), sipas të cilit K.M. ka qenë klient që nga muaji mars 2005 dhe është i përfshirë në kompanitë e mëposhtme si drejtues dhe aksioner:

Shoqëria “****” themeluar në 29.03.2005 dhe z. K.M është një nga dy drejtuesit dhe zotëron një nga dy aksionet e kompanisë.

- Pasqyra Financiare e shoqërisë *** për periudhën deri në dt.31.03.2006, (në gjuhën angleze). Fitimi i realizuar 10.500 Paund.
- Pasqyra Financiare e shoqërisë ***, për periudhën deri në dt. 31.03.2007, (në gjuhën angleze). Fitimi i realizuar 18.973 Paund.
- Pasqyra Financiare e shoqërisë ***, për periudhën deri në dt. 31.03.2008, (në gjuhën angleze). Fitimi i realizuar 21.916 Paund.

➤ **Hetimi i kryer nga Trupa Vlerësuese pranë AMP:**

50. Subjekti i vlerësimit z. Qato në formularët e tij të deklarimit të pasurisë deklaroi se nga shtetasi K.R.M i dtl. 09.05.1965 janë transferuar dy shuma. Njëra me datë 29.05.2008 në shumën 8.500 paund dhe tjetra me datë 03.06.2008 në shumën 10.000 paund.

Me deklaratën noteriale nr.*** rep. dhe nr. *** kol. të datës 23.06.2023, deklarues K.M, shtetas Britanik deklaroi me përgjegjësi të plotë se i ka transferuar Z. Altin Qato vlerën prej 18.500 paund. Këtë vlerë e ka transferuar për llogari të vjehrrit të tij, I.B i cili me këtë shumë do të paguante për llogarinë time blerjen e një pronë të paluajtshme me adresë Draç Durrës, pasi vjehrrri nuk kishte nr. llogarie.

Tirana Bank me shkresën nr. *** prot., datë 12.05.2023, konfirmon llogari rrjedhëse në emër të Altin Qato. Konfirmohet kreditimi i shumës 8.500 GBP në datë 29.05.2008 dhe i shumës 10.000 GBP, në datë 03.06.2008. Shuma të tërhequra me datë 11.07.2008 nga Altin Qato.

Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit shoqëruar në dosjen e subjektit rezultoi se z. K.M. ka patur mundësi financiare për dërgimin e shumës prej 18.500 paund, nga dokumentacioni rezultoi se z. K.M është një nga dy drejtuesit dhe zotëron një nga dy aksionet e kompanisë “****”, pasqyrat financiare në dosjen e subjektit e vërtetojnë këtë fakt.

✓ **Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e administruar gjatë hetimit administrativ.**

51. Subjekti deklaroi se me datë 09.07.2008 në llogarinë e tij në Tirana Bank në nr. e llogarisë 0140*** sipas vërtetimit (printim) të datës 18.04.2018 shtetasi E.B i biri i I.B transferoi shumën prej 12.314 euro. Kjo transfertë është bërë për z. I.B, i cili do të kryente disa pagesa financiare për llogari të shtetasit E.B, pasi mosha e thyer e kishte të vështirë ti kryente ato pagesa. Në pyetësorin shtesë subjekti ka deklaruar se edhe në rastin e dërgimit të shumës nga E.B, ato janë dërguar për llogari të z. K.M

Z. K.M. në deklaratën e tij noteriale me nr.*** rep. dhe nr.*** kol. datë 26.06.2023 deklaroi se vlerën financiare prej 12.314 euro që zoti E.B ka dërguar në llogarinë bankare të z. Altin

Qato në vitin 2008, ky i fundit i ka marrë në dorëzim për llogarinë time, pasi më duheshin ti përdorja për blerjen e një toke në Gjirin e Lalëzit Durrës.

➤ **Hetimi i kryer nga Trupa Vlerësuese:**

52. Në formularin e vetëdeklarimit të pasurisë për vlerësimin kalimtar subjekti ka deklaruar:

- Transfertë në Tirana Bank me vlerë 12.314 euro, sipas vërtetimit datë 18.04.2018 i Tirana Bank, nga shtetasi E.B, i biri i shtetasit I.B i cili do të kryente disa pagesa financiare për llogari të shtetasit E.B pasi nuk kishte nr. llogarie bankare. Kjo transfertë është bërë në llogarinë time bankare nr.0140***, dhe për shkak të moshës së tij e kishte të vështirë ti kryente ato pagesa.
- ✓ Subjekti në deklaratën e tij vetting deklaroi se shuma e dërguar në llogari të tij nga shtetasi E.B i biri i shtetasit I.B i cili do të kryente disa pagesa financiare për llogari të shtetasit E.B, dhe jo për llogari të shtetasit K.M ashtu siç thuhet në deklaratën noteriale me nr. *** rep. dhe nr. *** kol. datë 26.06.2023, i cili sqaron edhe destinacionin e dërgimit të shumës 12.314 nga E.B, i cili nga deklaratimet e subjektit rezulton i kundërt me atë çfarë thuhet në deklaratë.
- ✓ Gjithashtu konfirmohet nga Tirana Bank me shkresën Nr. *** prot., datë 12.05.2023 llogari në monedhën euro, në të cilën është transferuar shuma prej 12.314 euro, në datë 09.07.2008 nga E.B, shumë e tërhequr në datë 21.07.2008.

Nisur nga ky fakt me e-mailin e datës 27.09.2023, subjektit të vlerësimit ju kërkua që të japë shpjegime për këtë ndryshim deklarimi. Si edhe të sqarojë lidhjen me këto persona.

Subjekti me e-mailin zyrtar të datës 06.01.2023 e protokolluar me tonën nr. *** datë 09.10.2023 ka shpjeguar se: *Dua të sqarojë që nuk kam patur qëllim për të bërë ndryshim deklarimi. Në vetdeklarimin e pasurisë kam deklaruar se: Transfertë në Tirana Bank me vlerë 12.314 euro, sipas vërtetimit datë 18.04.2018 i Tirana Bank, nga shtetasi E.B, i biri i shtetasit I.B i cili do të kryente disa pagesa financiare për llogari të shtetasit E.B dhe nuk kishte nr. llogarie bankare. Kjo transfertë është bërë në llogarinë time bankare nr.0140*** dhe për shkak të moshës së tij e kishte të vështirë ti kryente ato pagesa.*

Në atë periudhë kur kam vetdeklaruar këtë informacion kam patur, pasi unë thjesht do prisja këtë transfert dhe vlerat monetare do ja jepja shtetasit I.B. Pasi mu kërkua informacion sqarues nga ILDKPI-ja, bëra verifikimet shtesë duke komunikuar me personat që kanë bërë transfertën për të plotësuar dokumentacionin sqarues që u kërkua dhe nga ILDKPI-ja. Pas sqarimeve me ta, u informova që transferta e kryer nga E.B, në llogarinë time bankare ka qenë për llogari të kunatit të vet shtetasit K.M. Në përgjigjet drejtuar ILDKPI-së është sqaruar burimi i të ardhurave të K.M si dhe arsyeja e transfertave (bashkëlidhur u dërgua dhe dokumentacioni vërtetues). Unë me shtetasin I.B në atë kohë kam qenë fqinjë në banesën ku kam jetuar me prindërit para se të transferohesha në banesën që jetojë aktualisht. Përveç këtij fakti jemi miq familje, pasi me prejardhje vijmë nga e njëjta zonë. E.B është i biri i I.B dhe K.M është dhëndëri i tij, pra është bashkëshorti i të bijës së I.B Periudha që janë bërë transfertat unë nuk kam qenë i angazhuar me punë dhe më është kërkuar nga shtetasi I.B që për shkak të moshës së tij të mos hapte ai llogari bankare, por të vinin transfertat në llogarinë time dhe unë pasi ti tërhiqja ti dorëzoja të ai, i cili kishte për të bërë pagesa për ta. Ky ishte një veprim thjesht për humanizëm nisur nga marrëdhënia që kishim me familjen B. Unë nuk kam përfutuar dhe nuk kam justifikuar asnjë shpenzim timin me këto transfertat.

- ✓ **Nisur nga faktet e mësipërme bazuar në dokumentacioni e administruar në dosje, përgjigjet e subjektit Trupa Vlerësuese arrin në konkluzion se subjekti ka bërë deklaram të saktë.**

53. Në pyetësorin shtesë Z. Qato subjekt i vlerësimit kalimtar është pyetur edhe për burimin e krijimit të shumës prej 15.000 euro e depozituar me datë 08.12.2006 si edhe destinacionin e shumave të tërhequra nga depozita.

Subjekti është përgjigjur dhe ka argumentuar se burimi i shumës së depozituar me datë 08.12.2006 është nga të ardhurat e mija nga puna e bashkëshortes dhe familjarëve. Destinacioni i shumave të tërhequra kanë shërbyer për pagesa të apartamentit si edhe pajisjeve të ndryshme shtëpiake.

❖ **Hetimi i kryer nga Trupa Vlerësuese:**

54. Në nxjerrjen e llogarisë bankare printuar me datë 18.04.2018 konstatohet se me datë 08.12.2006 është depozituar nga z. Altin Qato shuma prej 15.000 Euro, në llogarinë e tij bankare me nr. 0140 ***. Kjo shumë është krijuar me të ardhurat e krijuara nga puna e subjektit të vlerësimit bashkëshortja e tij si edhe e familjarëve të tij ndër vite.

Referuar shkresës Nr.*** prot., datë 08.05.2023 të Raiffeisen Bank konfirmon të ardhurat nga zbatimi i vendimit gjyqësor nr. *** dt. 28.06.2006 më datë 28.12.2006 në shumën 665.583 lekë. Nga analiza e bërë nga trupa vlerësuese deri në momentin e krijimit të depozitës sipas tabelës financiare bashkëlidhur rezulton se subjekti ka patur mundësi financiare për krijimin e depozitës prej 15.000 Euro.

Trupa vlerësuese arrin në konkluzionin se:

- ✓ **Referuar analizës financiare në tabelën bashkëlidhur rezulton se z. Altin Qato ka patur mundësi financiare me burim të ligjshëm për krijimin e depozitës prej 15.000 euro. Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e administruar gjatë hetimit administrativ si edhe me përgjigjet e ardhura nga bankat.**

55. Subjekti në formularin e tij të deklaramit ka deklaruar:

✚ Deklaron depozitë 12 mujore në Raiffeisen Bank për periudhën nga 08.02.2010 deri më 08.02.2011 me vlerë investimi 700.000 lekë me interes neto 35.910 lekë.

✚ Deklaron të ardhura nga investimi depozite 12 mujore në Raiffeisen Bank për periudhën nga 09.02.2011 deri më 09.02.2012 me vlerë investimi 1.000.000 lekë me interes neto 49.500 lekë.

✚ Deklaron të ardhura nga investimi depozitë 12 mujore në Raiffeisen Bank për periudhën nga 10.02.2012 deri më 10.02.2013 me vlerë investimi 1.200.000 lekë me interes neto 55.230 lekë.

✚ Deklaron të ardhura nga investimi depozitë 12 mujore në Raiffeisen Bank për periudhën nga 11.02.2013 deri më 11.02.2014 me vlerë investimi 1.500.000 lekë me interes neto 55.350 lekë.

✚ Deklaron të ardhura nga investimi depozitë 12 mujore në Raiffeisen Bank për periudhën nga 12.02.2015 deri më 12.02.2016 me vlerë investimi 2.000.000 lekë me interes neto 3.400 lekë.

✚ Deklaron se në Raiffeisen Invest fondin Raiffeisen Prestigj për periudhën 06.07.2016 deri më 09.04.2019 me vlerë investimi 2.500.000 lekë, investim total deri me 09.04.2019, 3.250.000 lekë. Fitimi i realizuar 293.267 lekë

✚ Bono thesari në Raiffeisen Bank sha nr. ankand ***, me vlerë 4.000.000 lekë. Datë emetimi 25.04.2019, dhe datë maturimi 23.04.2020 vlera neto e përfituar 37.589 lekë.

- ✚ Bono thesari në Raiffeisen Bank sha nr. ankand ***, me vlerë 1.100.000 lekë. Datë emetimi 04.06.2020, dhe datë maturimi 03.01.2021 vlera neto e përfituar 18.606 lekë.
- ✚ Obligacione në Raiffeisen Bank nr. ankand *** me vlerë 2.900.000 lekë. Datë emetimi 21.04.2020 dhe datë maturimi 21.04.2022, vlera veto e përfitimit 31.429 lekë.
Burimi im krijimit, kursimet ndër vite nga të ardhurat familjare.

❖ **Hetimi i kryer nga Trupa Vlerësuese:**

56. Raiffeisen Bank, me shkresën nr. *** prot., datë 08.05.2023, konfirmon të ardhurat nga zbatimi i vendimit gjyqësor nr. ***, dt. 28.06.2006, kaluar më dt. 28.12.2006, në masën 665.568 lekë, si dhe nga paga e subjektit për periudhën tetor 2008 - shkurt 2023, në shumën totale 13.686.389 lekë. (Për periudhën janar 2018 - shkurt 2023, në shumën 6.470.716 lekë). Të ardhura si lektor në dt. 10.01.2020, në shumën 107 euro.

Konfirmohen Bono Thesari, në emër të subjektit për periudhën;

- a) 25.04.2019 - 23.04.2020, në shumën 4.000.000 lekë,
- b) 04.06.2020 - 03.06.2021, në shumën 1.100.000 lekë,
- c) 21.04.2020 - 21.04.2022, në shumën 2.900.000 lekë.

57. Sipas lëvizjes së llogarisë, ka rezultuar hapje depozite në shumën 700.000 lekë, në dt. 08.02.2010 (me burim të ardhurat nga paga për periudhën 10.03.2008 - 03.02.2010) maturimi dhe furnizimi i saj nga llogaria e pagës dhe konkretisht maturuar dhe transferuar nga llogaria e pagës shuma 264.100 lekë, balancë 1.000.000 lekë.

Maturuar dhe transferuar nga llogaria e pagës, shuma 150.000 lekë, në dt. 10.02.2012, balanca 1.200.000 lekë.

Maturuar dhe transferuar nga llogaria e pagës shuma 244.800 lekë, në dt. 06.02.2013, balanca 1.500.000 lekë.

Maturuar dhe transferuar nga llogaria e pagës shuma 444.526 lekë, në dt. 12.02.2015, balanca 2.000.000 lekë.

Mbyllur depozita në dt. 04.06.2016, në shumën 2.003.400 lekë.

Kaluar nga llogaria e pagës shuma 496.585 lekë, në dt. 06.07.2016 dhe shuma totale prej 2.500.000 lekë, investuar në Raiffeisen Prestigj, deri në dt. 09.04.2019, ku është transferuar në llogarinë rrjedhëse shuma totale 3.595.020 lekë (diferenca e shumës fillestare dhe asaj përfundimtare janë shuma të transferuara çdo muaj nga llogaria e pagës prej 30.000 lekë).

Raiffeisen Invest me shkresën nr. *** prot., datë 11.05.2023 konfirmon Fondin Raiffeisen Prestigj në emër të Altin Qato për periudhën nga 06.07.2016 deri me 09.04.2019 ku është investuar shuma 2.500.000 lekë dhe tërhequr shuma 3.595.020 lekë. Fitimi i realizuar në shumën 345.202 lekë minus tatimi 51.753 lekë dhe fitim neto 293.267 lekë.

Në dt. 18.04.2019, është kredituar në llogari nga Altin Qato, shuma 325.000 lekë dhe kaluar në obligacione shuma totale 4.000.000 lekë, deri në datë 23.04.2020. Rezulton kthim fondesh, në dt. 11.05.2020, në shumën 1.100.549 lekë, të cilat janë rinvestuar në obligacione në dt. 27.05.2020 deri në dt. 03.06.2021. Më dt. 21.04.2022, rezulton maturimi i obligacioneve në shumën 2.900.000 lekë.

Trupa vlerësuese arrin në konkluzionin se:

58. Referuar deklarimeve të subjektit, përgjigjet e ardhura nga Raiffeisen Bank si edhe tabelës së rezultatit financiar të hartuar nga Trupa Vlerësuese pranë AMP, rezulton se Z. Altin Qato ka bërë deklaram të saktë dhe ka patur mundësi financiare, me burime të ligjshme, për kryerjen e të gjitha veprimeve si investimi i tyre në Depozitë, Bono Thesari, Obligacione dhe Raiffeisen Prestigj, pranë Raiffeisen Bank.

✓ **Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e administruar gjatë hetimit administrativ.**

59. b .Subjekti deklaron: Llogari rrjedhëse në Raiffeisen Bank, shuma 100 Euro.
Zotëron 100%.

Bashkëlidhur deklaratës:

➤ Nxjerrje llogarie nga Raiffeisen Bank në emër të Altin Qato, dt. 06.03.2023.

Konfirmohet balanca e llogarisë në dt. 31.12.2022, në shumën 100 euro.

• Raiffeisen Bank, me shkresën nr. *** prot., datë 08.05.2023, konfirmon llogari në emër të Altin Qato, me balancë në dt. 10.03.2023, shumën 100 Euro.

✓ **Konfirmohet deklarami me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e Raiffeisen Bank.**

60. c. Gjendje cash shuma 300.000 lekë. Burimi i krijimit: Kursime nga paga. Zotëron 100%.

✓ **Të ardhurat e realizuara justifikojnë gjendjen cash të deklaruar sipas tabelës së rezultatit financiar të hartuar nga Trupa Vlerësuese pranë AMP.**

61. d. Gjendje cash 4.000 Euro. Burimi i krijimit: Të ardhura nga shitja e automjetit, shuma 4.000 euro. Zotëroj 100%.

Bashkëlidhur deklaratës:

✓ Kontratë Shitje automjeti nr. *** rep, nr. *** kol, dt. 20.12.2018. Automjet Benz, nr. shasie WDB2100261B047***, me targë TR***N, në shumën 4.000 euro.

62. DPSHTRR, me shkresën nr. *** prot., datë 11.05.2023, konfirmon se Altin Qato ka pasur në pronësi automjetin me targë TR***N.

Bashkëlidhur:

✓ Kontratë Blerje automjeti nr. *** rep, nr. *** kol, dt. 26.02.2007, Mercedes Benz, nr. shasie WDB2100261B04***, me targë TR*** M, në vlerën 500.000 lekë.

✓ Kontratë Shitje automjeti nr. *** rep, nr. *** kol, dt. 20.12.2018. Automjet Benz, nr. shasie WDB2100261B04***, me targë TR***N, në shumën 4.000 euro.

Bazuar në deklaramin e subjektit, dokumentacionin e paraqitur, si dhe në korrespondencën e administruar nga ILDKPKI, në mënyrë të përmbledhur rezulton se;

Automjeti Mercedes Benz me targa TR***M është blerë nga subjekti në v. 2007, në shumën 500.000 lekë dhe është shitur në v. 2018, në shumën 4.000 Euro.

❖ **Hetimi i kryer nga Trupa Vlerësuese:**

63. Nga shqyrtimi i dokumentacionit shoqërues në dosjen e subjektit si edhe në përgjigje e ardhur nga DPSHTRR me shkresën nr.*** konfirmohet se z. Altin Qato ka patur në pronësi një automjet me tragë TR***N, të cilën me kontratë shitje nr. *** rep. dhe *** kol. datë 20.12.2018

e ka shitur me vlerën 4.000 euro, shumë kjo e konvertuar me kursin e këmbimit valutor në atë periudhë prej 134.5 lekë e barabartë me 538.000 lekë. Kjo vlerë rezulton se është më e lartë se çmimi fillestar i blerjes.

- ✓ **Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ardhur nga DPSHTRR.**
- ✓ **Të ardhurat e realizuara justifikojnë gjendjen cash të deklaruar sipas tabelës së rezultatit financiar të hartuar nga Trupa Vlerësuese.**

64. f. Sipas shkresës nr.*** prot., datë 08.05.2023 ardhur nga Raiffeisen Bank sha, konfirmon gjendje në llogarinë e pagës në Raiffeisen Bank, më dt. 10.03.2023, në emër të Altin Qato, shuma 3.501.257 lekë.

Burimi i krijimit: Kursime nga paga.

Zotëron 100%.

❖ **Hetimi i kryer nga Trupa Vlerësuese:**

Nga analiza tërësore ekonomike që është kryer për subjektin e vlerësimit dhe personat e lidhur me të nga koha e fillimit të detyrës e deri në datën e dorëzimit të deklaratës Vetting, rezulton se subjekti disponon gjendje balancë kursime në vlerën 3.501.257 lekë

Raiffeisen Bank, me shkresën nr. *** prot., datë 08.05.2023, konfirmon llogari page në emër të Altin Qato, me balancë në dt.10.03.2023, shumën 3.501.257 lekë, çelur që nga viti 2006, ku evidentohen që janë vetëm të ardhurat nga ekzekutimi i vendimit gjyqësor, paga dhe shpërblimet, si dhe kthimi në llogarinë rrjedhëse të fondit të investuar. Overdraft me limit 50.000 lekë.

Bazuar në tabelën e rezultatit financiar bashkëlidhur rezulton se subjekti i vlerësimit ka patur mundësi financiare me burime të ligjshme për krijim e gjendjes së llogarisë në shumën 3.501.257 lekë.

- ✓ **Konfirmohet deklarimi me përgjigjen e ardhur nga Raiffeisen Bank.**

65. **Deklarimi i të ardhurave:**

- Të ardhura nga paga, shpërblime dhe përfitime të tjera financiare nga detyra sipas vërtetimit të Drejtorisë Vendore të Policisë Berat për periudhën 01.08.1993-16.03.1995, shuma 144.159 lekë.
- Të ardhura nga paga, shpërblime dhe përfitime të tjera financiare të fituara nga detyra, sipas Vërtetimit nr. ***, dt. 16.04.2018, të Drejtorisë Vendore të Policisë Elbasan, për periudhën 16.07.1995 - 28.02.1997, shuma 269.529 lekë.
- Të ardhura nga paga, shpërblime dhe përfitime të tjera financiare të fituara nga detyra, sipas vërtetimit nr. ***, dt.12.04.2018, të Drejtorisë Vendore të Policisë Fier, për periudhën 16.08.1997 - 15.01.1998, shuma 47.454 lekë.
- Të ardhura nga paga, shpërblime dhe përfitime të tjera financiare të fituara nga detyra, sipas vërtetimit nr. ***, dt.12.04.2018, të Drejtorisë Vendore të Policisë Berat, për periudhën 01.04.1997 - 15.08.1997 dhe 01.05.1999 - 16.10.1999, shuma 141.478 lekë.
- Të ardhura nga paga, shpërblime dhe përfitime të tjera financiare të fituara nga detyra, sipas vërtetimit të ardhur me e-mail, dt.14.04.2018, nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Korçë, për periudhën 16.01.1998 - 10.08.1998, shuma 113.909 lekë.

- Të ardhura nga paga, shpërblime dhe përfitime të tjera financiare të fituara nga detyra, sipas vërtetimit të Drejtorisë Vendore të Policisë Durrës, për periudhën 16.09.1999 - 30.11.2002, shuma 865.193 lekë.
 - Të ardhura nga paga, shpërblime dhe përfitime të tjera financiare të fituara nga detyra, sipas vërtetimit të Drejtorisë Vendore të Policisë Lezhë, për periudhën 2003 - 2004, shuma 640.178 lekë.
 - Të ardhura nga paga, shpërblime dhe përfitime të tjera financiare të fituara nga detyra, sipas vërtetimit të Drejtorisë Vendore të Policisë Shkodër, për periudhën 25.03.2004 - 25.05.2004, shuma 122.048 lekë.
 - Të ardhura si punonjës i shoqërisë "****" shpk., Rrëshen. Vërtetim i shoqërisë "****" sh.p.k, shuma 742.852 lekë.
 - Të ardhura nga paga, banues, shpërblime dhe shpenzime gjyqësore e përfitime të tjera financiare të fituara nga detyra, sipas Vërtetimit të ardhur me e-mali nga Raiffeisen Bank, dt. 19.04.2018, për periudhën 2006 - 2017, shuma 13.458.800 lekë.
 - Të ardhura nga investimi Depozitë 12 mujore në Raiffeisen Bank, për periudhën 08.02.2010 - 08.02.2011, me vlerë investimi 700.000 lekë dhe interes 35.910 lekë.
 - Të ardhura nga investimi Depozitë 12 mujore në Raiffeisen Bank, për periudhën 09.02.2011 - 09.02.2012, me vlerë investimi 1.000.000 lekë dhe interes neto 49.500 lekë.
 - Të ardhura nga investimi Depozitë 12 mujore në Raiffeisen Bank, për periudhën 10.02.2012 - 10.02.2013, me vlerë investimi 1.200.000 lekë dhe interes neto 55.230 lekë.
 - Të ardhura nga investimi Depozitë 12 mujore në Raiffeisen Bank, për periudhën 11.02.2013 - 11.02.2014, me vlerë investimi 1.500.000 lekë dhe interes neto 55.350 lekë.
 - Të ardhura nga investimi Depozitë 12 mujore në Raiffeisen Bank, për periudhën 12.02.2015 - 12.02.2016, me vlerë investimi 2.000.000 lekë dhe interes neto 3.400 lekë. (Shuma totale e përfituar 199.390 lekë).
 - Të ardhura nga paga dhe shpërblime dhe përfitime të tjera financiare të fituara (DPPSH-ja), për periudhën 01.01.2018 - 15.02.2018, shuma 175.740 lekë.
 - Të ardhura nga paga dhe shpërblime dhe përfitime të tjera financiare, të fituara nga detyra sipas Vërtetimit me nr. ***, dt. 23.02.2023, të ardhura nga Akademia e Sigurisë, për periudhën 15.04.2019 - 31.10.2021, shuma 2.829.939 lekë.
 - Të ardhura nga paga dhe shpërblime dhe përfitime të tjera financiare të fituara nga detyra, për periudhën 01.11.2021 - 31.12.2021, shuma 314.273 lekë.
 - Të ardhura nga paga dhe shpërblime dhe përfitime të tjera financiare të fituara nga detyra, (Drejtorja e Përgjithshme), për periudhën 01.01.2022 - 01.03.2023, shuma 1.561.846 lekë.
 - Fitime nga pjesëmarrja në Fondin e Investimit Raiffeisen Prestige, për periudhën 06.07.2016 deri 09.04.2019, me vlerë investimi 3.250.000 lekë. Tërhequr në dt. 09.04.2019, vlera 3.595.020 lekë, nga e cila fitimi vlera bruto 345.020 lekë dhe vlera neto 293.267 lekë.
- Fitime nga pjesëmarrja në:**
- a) Bono Thesari në Bankën Raiffeisen sha, nr. ankandi ***, me vlerë 4.000.000 lekë, datë emetimi 25.04.2019 dhe datë maturimi 23.04.2020. Vlera neto e përfitimit 37.589,35 lekë).
 - b) Bono Thesari në Bankën Raiffeisen sha, nr. ankandi ***, me vlerë 1.100.000 lekë, datë emetimi 04.06.2020 dhe datë maturimi 03.01.2021 (Vlera neto e përfitimit, 18.606,65 lekë)

c) Obligacione në Bankën Raiffeisen sha, nr. ankandi ***, me vlerë 2.900.000 lekë datë emetimi 21.04.2020 dhe datë maturimi 21.04.2022 (Vlera neto e përfitimit 31.429 lekë)
Shuma totale e përfituar 87.625 lekë.

Burimi i të ardhurave: Kursime ndër vite nga të ardhurat familjare.

Dokumentacioni Shoqërues:

- Vërtetim për bazën e vlerësueshme, nga ISSH, ku konfirmohen të ardhurat për periudhën 01.08.1993 deri në 16.03.1995, në shumën totale 144.159 lekë.
- Vërtetim page nga Drejtoria Vendore e Policisë Elbasan, nr. *** prot., dt. 16.04.2018. Vërtetohen të ardhurat periudha 16.07.1995 deri në 31.03.1997, në shumën totale 283.351 lekë.
- Vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare nga ISSH.
- Konfirmohen të ardhurat për Altin Qato për periudhën 01.04.1997 deri në 15.08.1997, në shumën neto 44.986 lekë dhe për periudhën 01.05.1999 deri në 16.10.1999, në shumën totale 96.492 lekë.
- Vërtetim nga Drejtoria Vendore e Policisë Fier, nr. *** prot., dt. 12.04.2018. Konfirmohen të ardhurat për periudhën 16.08.1997 deri në 15.01.1998, në shumën neto 47.454 lekë.
- Konfirmim i pagave (e-mail), dt.14.04.2018, nga Komisariati i Policisë Pogradec.
- Konfirmohen të ardhurat nga paga për periudhën 16.01.1998 deri në 10.08.1998, në shumën 113.909 lekë.
- Vërtetim nga Drejtoria Vendore e Policisë Durrës. Konfirmohen të ardhurat për periudhën 16.09.1999 deri më 30.11.2002, në shumën neto 865.193 lekë.
- Vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën mesatare. Konfirmohen të ardhurat 640.178 lekë, nga paga për periudhën janar 2003 - mars 2004.
- Vërtetim nga Drejtoria Vendore e Policisë Shkodër, ku vërtetohen të ardhurat nga paga për periudhën 25.03.2004 - 23.05.2004, në shumën neto 122.048 lekë.
- Vërtetim nga shoqëria "****" shpk., dt. 15.06.2008, ku vërtetohen të ardhurat për Altin Qato, për periudhën 2005 - 2007, në shumën totale 32.150 euro.
- Vërtetim për bazën e vlerësueshme, lëshuar nga punëdhënësi "****" sh.p.k. Konfirmohen të ardhurat për Altin Qato mbi të cilat janë derdhur kontributet, për periudhën 01.03.2007 - 31.08.2008, në shumën totale 742.852 lekë.
- Konfirmim me e-mail, dt.19.04.2018, i të ardhurave të kredituara në bankën Raiffeisen Bank, për Altin Qato, për periudhën 2006 - 2017, në shumën totale 13.458.800 lekë.
- Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr. *** Akti, dt. 25.10.2006, për lëshimin e urdhërit të ekzekutimit, ku është vendosur "Lëshimi i urdhërit të ekzekutimit për zbatimin e vendimit civil, nr. ***, dt. 20.10.2005, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, të ndryshuar me Vendimin nr. ***, dt. 28.06.2006, të Gjykatës së Apelit Tiranë". Me Vendimin nr. ***, dt. 28.06.2006, të Gjykatës së Apelit, është vendosur, "Ndryshimi i vendimit nr.***, dt. 20.10.2005, të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, dhe pranimi i kërkesë padisë. Anulimi i Urdhërit nr. ***, dt. 22.05.2004, të Ministrisë të Rendit Publik. Detyrimi i palës së paditur t'i paguajë paditësit Altin Qato, pagën e 12 muajve etj.
- Vërtetim page nr. *** prot., dt. 27.02.2023, nga Drejtoria Vendore e Policisë Elbasan. Konfirmohen të ardhurat e përfituara nga paga për Altin Qato, për periudhën 16.02.2018 deri në 14.04.2019, në shumën neto 1.388.669 lekë.
- Vërtetim nr. *** prot., dt. 23.02.2023, nga Akademia e Sigurisë, DPPSH.

- Vërtetohen të ardhurat nga paga, shpërblime, veshje dhe dieta për Altin Qato, për periudhën 15.04.2019 deri në 01.11.2021, në shumën totale neto 2.829.939 lekë.
- Vërtetim nga DPPSH, ku konfirmohen të ardhurat për Altin Qato, për periudhën 01.01.2018 - 15.02.2018, në shumën neto 175.740 lekë. Për periudhën 01.11.2021 - 31.12.2021, në shumën neto 314.273 lekë dhe për periudhën 01.01.2022 - 28.02.2023, në shumën totale neto 1.561.846 lekë.

Interesat bankare të depozitave :

- Nxjerrje llogarie nga Raiffeisen Bank, ku konfirmohen të ardhurat nga interesat e depozitave për periudhën 08.02.2010 - 04.07.2016, në shumën totale neto rreth 199.390 lekë.

Konfirmohen depozitat, si më poshtë;

- dt.08.02.2010 - 08.02.2011, në shumën 700.000 lekë,
- dt.09.02.2011 - 09.02.2012, në shumën 1.000.000 lekë,
- dt.10.02.2012 - 10.02.2013, në shumën 1.200.000 lekë,
- dt.11.02.2013 - 11.02.2014, në shumën 1.500.000 lekë,
- dt.12.02.2015 - 12.02.2016, në shumën 2.000.000 lekë,
- dt.12.02.2016 - 04.07.2016, në shumën 2.003.400 lekë.

Gjithashtu konfirmohet fond investimi në Raiffeisen Bank, për periudhën 25.04.2019 - 23.04.2020, në shumën 4.000.000 lekë. Në dt. 04.06.2020 - 03.06.2021, në shumën 1.100.000 lekë dhe për periudhën 21.04.2020 - 21.04.2022, shumën 2.900.000 lekë.

- Vërtetim mbi pasqyrën e llogarisë në emër të Altin Qato, në dt. 01.12.2021. Konfirmohet fondi i investuar në dt. 06.07.2016, në shumën 2.500.000 lekë deri në dt. 09.04.2019, ku është tërhequr shuma 3.595.020 lekë. Fitimi i realizuar 345.020 lekë bruto dhe neto rreth 293.267 lekë.
- Vërtetim për shpalljen e fituesit për blerje Bonove të Thesarit nga Raiffeisen Bank, me datë emetimi 25.04.2019 dhe datë maturimi 23.04.2020. Shuma 4.000.000 lekë. Interesi neto i përfituar 37.590 lekë.
- Vërtetim për shpalljen e fituesit për blerje Bonove të Thesarit nga Raiffeisen Bank, me datë emetimi 21.04.2020 dhe datë maturimi 21.04.2022. Shuma 2.900.000 lekë. Interesi neto i përfituar 31.429 lekë.
- Vërtetim për shpalljen e fituesit për blerje Bonove të Thesarit nga Raiffeisen Bank, me datë emetimi 04.06.2020 dhe datë maturimi 03.06.2021. Shuma 1.100.000 lekë. Interesi neto i përfituar 18.607 lekë.

DEKLARIMI I PERSONIT TË LIDHUR E. QATO

DEKLARIMI I PASURIVE:

66. i. Gjendje në llogarinë e pagave bankomat, në Tirana Bank , me dt. 10.03.2023, në emër të E. Qato, shuma 427.896 lekë.

Burimi i krijimit: Nga pagat ndër vite. Zotëron 100%.

Tirana Bank, me shkresën nr. *** prot., dt. 12.05.2023, konfirmon llogari page në emër të E. Qato, me balancë në dt. 10.03.2023, shumën 427.896 lekë.

- ✓ **Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ardhur nga Tirana Bank sha.**

DEKLARIMI I TË ARDHURAVE:

- Të ardhura nga paga si punonjëse e Njesisë Administrative Pishaj, Bashkia Gramsh, sipas vërtetimit nr.***, dt. 24.04.2018, për periudhën shtator 1996 deri në dhjetor 2006, në shumën 574.651 lekë.
- Të ardhura nga paga si punonjëse e Njesisë Administrative Kukur, Bashkia Gramsh, sipas vërtetimit të lëshuar nga kjo njësi, në shumën 261.505 lekë.
- Të ardhura nga pagesa e papunësisë, sipas vërtetimit, nr.***, dt. 23.04.2018 dhe vërtetimit nr.***, dt. 23.04.2018, i Shërbimit Kombëtar të Punësimit, Zyra Vendore e Shërbimit Kombëtar të Punësimit Gramsh, në shumën 55.820 lekë.
- Të ardhura nga paga si punonjëse në shoqërinë “***” sh.p.k, për periudhën 16.08.2002 - 15.10.2002, në shumën 18.805 lekë.
- Të ardhura nga paga si punonjëse e shoqërisë “***” sh.p.k, për periudhën 01.04.2009 - 12.10.2009 dhe periudhën 01.11.2010 - 30.09.2011, sipas vërtetimit të kësaj shoqërie, në shumën 329.636 lekë.
- Të ardhura nga paga si punonjëse në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për periudhën 11.02.2012 - 10.2013, sipas vërtetimit të këtij institucioni, në shumën 866.884 lekë.
- Të ardhura nga paga si punonjëse në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, për periudhën 01.11.2013 - 01.01.2018, sipas vërtetimit të këtij institucioni, në shumën 2.608.976 lekë.
- Të ardhura nga paga si punonjëse në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, për periudhën 01.01.2018 - 01.02.2023, sipas vërtetimit të këtij institucioni me nr.***, dt. 27.02.2023, në shumën 3.405.298 lekë.
- Të ardhura nga shtesa mbi pagën mujore për natyrë të veçantë pune, janar 2018 - nëntor 2022, sipas vërtetimit të institucionit me nr.***, dt.19.01.2023, në shumën 335.175 lekë.
- Të ardhura nga paga si punonjëse në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, për periudhën 01.02.2023 - 01.03.2023, në shumën 59.097 lekë.

Bashkëlidhur deklaratës:

- ✓ Vërtetim page për Elena Latifi, nr.*** prot., dt. 24.04.2018, lëshuar nga Njësia Administrative Pishaj. Të ardhura nga paga për periudhën shtator 1996 - tetor 2001 dhe janar 2002 - gusht 2002, në shumën totale neto 214.556 lekë. Për periudhën shtator 2005 - janar 2007, në shumën totale 360.095 lekë.
- ✓ Vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare, lëshuar nga ISSH. Konfirmohen të ardhurat nga paga për E. Latifi, për periudhën nëntor - dhjetor 2001, në shumën 24.534 lekë, për periudhën tetor 2003 - gusht 2004, në shumën totale neto 152.697 lekë.
- ✓ Vërtetim nr. *** prot., dt. 23.04.2018, nga Zyra Vendore Shërbimit Kombëtar Punësimit Gramsh. Konfirmohen të ardhurat nga paga për E. Latifi, për periudhën 15.10.2002 - 16.10.2003, në shumën totale 40.860 lekë.
- ✓ Vërtetim për bazën e vlerësuar dhe pagën neto mesatare, lëshuar nga ISSH, Drejtoria Rajonale Elbasan. Të ardhurat për E. Latifi për periudhën 16.08.2002 - 15.10.2002 në shumën bruto totale 18.805 lekë.
- ✓ Vërtetim për bazën e vlerësueshme, lëshuar nga ISSH. Konfirmohen të ardhurat për E. Qato për periudhën 01.4.2009 - 12.10.2009, në shumën rreth 117.636 lekë dhe për periudhën nëntor 2010 - shtator 2011, në shumën 212.000 lekë.

- ✓ Vërtetim për bazën e vlerësueshme, lëshuar nga ISSH. Konfirmohen të ardhurat për E. Qato, për periudhën 11.02.2012 - tetor 2013, në shumën rreth 866.884 lekë.
 - ✓ Vërtetim për bazën e vlerësueshme, lëshuar nga ISSH. Konfirmohen të ardhurat për E. Qato për periudhën 01.11.2013 - 31.12.2017, në shumën rreth 2.608.978 lekë.
 - ✓ Vërtetim nr. *** prot., dt. 27.02.2023, nga Ministria e Financave. Konfirmohen të ardhurat nga paga, për periudhën janar 2018 - shkurt 2023, në shumën totale neto 3.464.395 lekë.
 - ✓ Vërtetim nr. *** prot., dt. 19.01.2023, nga Ministria e Financave. Konfirmohen të ardhurat nga paga për E. Qato, për vitin 2022, në shumën neto 688.564 lekë. Ndihmë financiare 10.000 lekë. Shtesë mbi pagën mujore për natyrë të veçantë pune janar 2018 - nëntor 2021, në shumën 335.175 lekë.
67. Tirana Bank, me shkresën nr. *** prot., datë 12.05.2023, konfirmon të ardhurat nga paga për E. Qato për periudhën shkurt 2012 - shkurt 2023, në shumën totale rreth 7.295.349 lekë.
68. ISSH, me shkresën nr.*** prot., datë 10.05.2023, konfirmon kontributet e derdhura për E. Qato, për periudhën shkurt 2012 - mars 2023.
69. ISSH, Drejtoria e Arkivit Qendror, me shkresën nr. *** Prot., datë 17.05.2023, konfirmon se *nga mënyra e administrimit dhe përpunimit të listë pagesave për periudhën 1994 - 2012, të punonjësve të siguruar në subjektet juridike apo fizike, nuk mund të konfirmojnë periudhën e kontributeve apo paga mbi të cilën janë siguruar, në qoftë se nuk jepen emërtimi i qendrës së punës, Nipti i subjektit, fotokopje e librezës së punës.*
- ✓ **Trupa Vlerësuese arrin në konkluzion se personi i lidhur bashkëshortja e subjektit të vlerësimit bazuar në tabelën e rezultatit financiar të hartuar nga Trupa Vlerësuese pranë AMP, ka patur mundësi financiare për krijimin e depozitës në shumën prej 427.896 lekë.**

SHPENZIMET E DEKLARUESHME:

70. Shpenzimet e deklarueshme të vitit të fundit kalendarik për ujë, drita, telefon dhe internet, si dhe të gjitha ato pagesa periodike për kontratat e furnizimit apo pajtimit në emër të subjektit ose personave të lidhur.

Periudha 01.01.2022 - 31.12.2022

- Shpenzime uji, viti 2022 (janar - dhjetor) në shumën 38.761 lekë.
- Shpenzime për energji elektrike, viti 2022 (janar - dhjetor), në shumën 84.989 lekë.
- Shpenzime telefonike, (për vete dhe familjarët), viti 2022 (janar - dhjetor), në shumën 50.000 lekë.
- Shpenzime interneti 28.000 lekë .
Bashkëlidhur deklaratës:
- Kopje e Librezës së UKT, në emër të Altin Qato, nr. kontrate 164***, Zona 26. Konfirmohet shlyerja e detyrimeve për vitin 2022 (janar - dhjetor), në shumën totale rreth 38.761 lekë
- Kopje e Librezës së OSHEE, në emër të E. Qato, nr. kontrate 193***, qendra Tiranë. Konfirmohet shlyerja e detyrimeve për vitin 2022 (janar - nëntor), në shumën totale rreth 76.670 lekë.
- FSHU, me shkresën nr. *** prot., datë 11.05.2023, konfirmon se me gjeneralitetet Altin Qato (nuk konfirmohet emri i babait), identifikohen 2 abonentë me kontratë furnizimi nr.

TRIG130142137***, në instancën Tiranë dhe nr. GJ0B020254096*** në instancën Sarandë. Me gjeneralitetet E.Qato identifikohet 1 abonent me nr. kontratë furnizimi TRIF040021193***, në instancën Tiranë.

- Shoqëria Rajonale Ujësjetllës - Kanalizime Tiranë, me shkresën nr. *** prot., datë 24.05.2023, konfirmon se në emër të Altin Qato, rezultojnë dy kontrata dhe konkretisht:
 - Nr. 3979*** për objektin me adresë rruga "****", me status "aktiv", me detyrime të likuiduara deri në muajin Mars 2023. Bashkëlidhur dokumenti identifikimi ID, kontratë shitje apartamenti nr. ***, dt. 07.09.2010, me palë blerëse A.Q. i dtl. 09.11.1970, me nr. pasaportë Z1099***. Shuma e paguar për vitin 2022, rreth 27.520 lekë.
 - Nr. 1649***, për objektin me adresë Rruga e Durrësit, me status "aktiv" me detyrime të likuiduara deri në muajin mars 2023. Shuma e paguar për vitin 2022 rreth 37.761 lekë.
- Shoqëria Rajonale Ujësjetllës - Kanalizime Sarandë, me shkresën nr.*** prot., dt. 11.05.2023, konfirmon 2 kontrata në emër të A.Q me UK-Sarandë, me nr.81971*** dhe nr. 81971***, që ndodhet në Lagja nr. 1, Rr. "****". Shuma e paguar për të dy kontratat për vitin 2022, rreth 21.072 lekë.
- 13-Shoqëritë Rajonale të Ujësjetllës - Kanalizime, me shkresat nr.*** - ***. Prot., nuk konfirmojnë kontrata të lidhura nga subjekti dhe personat e lidhur me të.
- Vodafone Albania sha, me shkresën nr. *** prot., dt. 12.06.2023, konfirmon se në emër të Altin Qato, figurojnë të regjistruar 2 numra telefoni dhe konkretisht 355694110*** nga data 26.02.2019 dhe 355694137*** nga data 05.05.2015. Shuma e paguar për vitin 2022, rreth 23.760 lekë.
- One Albania sha, me shkresën nr. *** prot., dt.07.06.2023, konfirmon se në emër të E. Qato, rezulton i regjistruar numri mobile me parapagesë 355675852*** dhe totali i rimbushjeve pagesave nga data 01.01.2022 deri në 31.12.2022 është 12.100 lekë.
- Albania Satellite Communications shpk, me shkresën nr. *** prot., dt.15.05.2023, nuk konfirmon kontrata të lidhura nga subjekti dhe personat e lidhur me të.
- Abissnet sha, me shkresën nr. ***-Prot., dt. 11.05.2023, konfirmon se Altin Qato është palë në kontratën e shërbimit të internetit, dt. 07.02.2020, e cila është kthyer në kontratë me afat të pacaktuar. Faturimi total i pagesave për periudhën 01.01.2022 - 31.12.2022 është 22.000 lekë.
- Digicom sha, me shkresën nr. *** prot., dt. 12.05.2023, konfirmon se Altin Qato me numër kontrate DG-22-70***, ka marrë shërbim interneti dhe është faturuar me faturim mujor në vlerën 2.000 lekë për periudhën 01.11.2022-31.12.2022.

➤ **Me inventarin nr. extra prot., datë 3.7.2023, subjekti ka dorëzuar në ILDKPKI:**

- Sqarime me shkrim, ku ka deklaruar se: Nuk ka asnjë objekt në emrin e tij në Sarandë dhe Izberisht, dhe ka paraqitur.
- Kthim përgjigje nga UKT, nr. K-16***Prot., dt. 20.06.2023, ku konfirmohet se kontrata me numër 39794***, është e regjistruar në emër të Altin Qato, me nr. pasaportë Z1099***, e ndryshme nga të dhënat e ID-së së kërkuesit Altin Qato, për objektin me adresë në rrugën "****".

Bashkëlidhur kopje të pasaportës së A.Q, i dt. 09.11.1970, nr. Pasaportë Z1099***

- Kthim përgjigje nr. *** Prot., dt. 20.06.2021, nga UK Sarandë, ku konfirmohet se kontratat e ujit me nr. 81971*** dhe nr. 81971***, Lagja nr.***, Rr. "****", Sarandë, i përkasin z. A.B.Q, i dt. 09.11.1970, vendlindja Berat, me dokument identiteti Italian, CA5453***.

➤ **Me inventarin nr. extra prot., datë 14.07.2023, subjekti ka dorëzuar në ILDKPKI:**

- Kthim përgjigje nga FSHU, nr. *** prot., dt. 14.07.2023, ku konfirmohet se referuar sistemit të faturimit, kontratat me nr. G-13*** me kod klienti TRIG13014213*** dhe me nr. B-96*** me kod klienti GJOB020254096***, rezultojnë në emër të A.Q, hapur përkatësisht më dt. 15.10.2008 dhe 19.09.2012. Sipas verifikimit në terren u konstatua se kontratat janë në emër të Altin Qato, por jo me ID e kërkuar.

Bashkëlidhur: Kërkesë nga Altin Qato me ID H103300***.

- Shpenzimet e deklaruara për ujë, energji elektrike, shpenzime telefonie dhe interneti, me kontrata në emër të subjektit dhe/apo personave të lidhur me të, në total për periudhën 01.01.2022 - 31.12.2022 janë rreth 202.000 lekë.

71. Për arsimin e fëmijëve, madhore apo të mitur, apo të personave të lidhur, duke deklaruar fillimin, llojin e institucionit arsimor, emrin e institucionit, pagesat vjetore, si dhe kohëzgjatjen e studimeve, sipas periudhës së përcaktuar në nenin 32, të Ligjit nr.12/2018, të ndryshuar. Periudha nga data e fillimit të punës në institucionin e Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Agjencisë së mbikëqyrjes Policore, deri në ditën e plotësimit të formularit të deklarimit të pasurisë.

- ✓ Shpenzime shkollimi për E. Qato (djali). Ka ndjekur në shkollën publike “Avni Rustemi” deri në klasë të III-të. Në vazhdim ndjek arsimin jo-publik në Kolegjin "****". Pagesa e shkollimit për E. Qato, është bërë nga babai im M.Q, sipas vërtetimit dt. 27.04.2018, i Kolegjit "****" Tiranë, nga të ardhurat që përfiton nga dhënia me qira e pronës së tij, me nr. pasurie 7/****.
- ✓ Shpenzime shkollimi për P. Qato (djali). Ndjek arsim jo-publik, në Kolegjin "****" Tiranë. Sipas vërtetimit të këtij institucioni, me nr. ***, dt. 06.03.2023, detyrimi financiar për periudhën 2016 - 2022, në shumën 25.925 euro. Burimi i krijimit: Të ardhura nga pagat.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Kthim përgjigje nga Institucioni Arsimor "****", nr. *** prot., dt. 06.03.2023. Konfirmohet se shuma e paguar për E. Qato (për shkollim, transport, uniformë, shërbime dixhitale dhe libra), për vitet 2016 - 2022, në shumën totale 25.581 euro.
- Kthim përgjigje nga institucioni Arsimor "****", me nr. *** prot., dt. 06.03.2023. Konfirmohet se shuma e paguar për P. Qato (për shkollim, transport, uniformë, shërbime dixhitale dhe libra), për vitet 2016 - 2022, në shumën totale 25.925 euro.
- Deklaratë nga M.Q, dt. 09.01.2019, ku konfirmohet se ka kryer pagesat e regjistrimit në Kolegjin "****" për nipin e tij E. Qato, nga viti 2016 e në vazhdim. Pagesat janë kryer nga të ardhurat e përfituara nga dhënia me qira e një dyqani, ku është bashkëpronar.
- Vërtetim dt. 27.04.2018, nga Kolegji "****", me anë të cilit vërtetohet se z. M.Q ka kryer pagesat e regjistrimit për nxënësin E. Qato, që nga viti 2016 deri në vitin aktual. Bashkëlidhur. Mandat arkëtimi dt. 25.05.2017, firmosur nga M.Q, ku konfirmohet pagesa e kryer për transport dhe libra, në shumën 549 euro. Mandat arkëtimi dt. 22.05.2017, firmosur nga M.Q,

ku konfirmohet pagesa e kryer për regjistrim, pagesë pjesore për libra dhe uniformën e shkollës, shuma 650 euro.

- Kontratë Qiraje, dt.17.10.2007. Qiradhënës M.Q dhe E.B, qiramarrës shoqëria "****" shpk, për objektin dyqan me sip. 200 m², në adresën Rr. "****", Tiranë, me afat 10-vjeçar, në shumën 150.000 lekë/muaj dhe nga kjo shumë M.Q do përfitojë 50.000 lekë/muaj dhe E.B 100.000 lekë/muaj.
- Vërtetim nga ISSH, për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare për M.Q, për periudhën maj - shtator 2002. Të ardhurat e përfituara në shumën neto 80.577 lekë.
- Vërtetim nga ISSH, nr. ***, në lidhje me të ardhurat e M.Q, për periudhën janar 1994 -janar 2002. Të ardhurat neto për periudhën tetor 1998 -prill 2002, në shumën neto 641.577 lekë.
- Vërtetim nga ISSH, nr.*** Prot., dt. 30.06.2023, mbi bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare për M.Q, për të ardhurat mbi të cilat janë derdhur kontributet, për periudhën tetor 2002 - janar 2005, në shumën totale 784.454 lekë. Për periudhën 10.02.2005 - 31.12.2007, në shumën totale neto 1.100.577 lekë dhe për periudhën 01.01.2008 - 31.12.2010, në shumën totale neto 1.474.279 lekë (për periudhën 01.01.2008 - 01.04.2008, në shumën totale neto 110.601 lekë).
- Kontrate Qiraje nr. *** Rep, nr. *** kol, dt. 31.05.2016. Qiradhënës M.Q dhe E.B dhe qiramarrës shoqëria "****" shpk, për objektin njësi me sip. 200 m², nr. pasurie 7/****, ZK.8310, në Tiranë, Rr. "****", me afat 3-vjeçar, në shumën 90.000 lekë/muaj.
- Kontratë Qiraje nr. *** rep, nr. *** kol, dt. 29.03.2018. Qiradhënës M.Q dhe E.B dhe qiramarrës Personi Fizik E.K, për objektin njësi me sip. 200 m², nr. pasurie 7/****, ZK.8310, në Tiranë, Rr. "****" (***), me afat 3-vjeçar, në shumën 98.000 lekë/muaj.
- Kontratë Qiraje, nr. *** rep, nr. *** kol, dt. 22.05.2020. Qiradhënës M.Q dhe E.B dhe qiramarrës shoqëria "****", për objektin njësi me sip. 200 m², nr. pasurie 7/****, ZK.8310, në Tiranë, Rr. "****", me afat 5-vjeçar, në shumën 900 euro/muaj. Nga e cila 600 euro do kalojnë në llogarinë e M.Q dhe 300 euro në llogarinë e E.B.
- Certifikatë për vërtetim pronësie për pasurinë me nr. 7/****, vol. ***, fq.***, ZK.8310, njësi me sip. 200 m², në emër të E.B dhe M.Q, lëshuar në dt. 27.02.2015.
- Kontratë Shitblerje pasurie e paluajtshme nr. *** rep, nr. 270 kol, dt. 05.03.2002, palë shitëse B. K. dhe palë blerëse M.Q dhe E.B. Dyqan me sip. 200 m², në Rr. "****" Tiranë.

Me inventarin nr. extra prot., datë 03.07.2023, subjekti ka dorëzuar në ILDKPKI:

- Sqarime me shkrim, ku ka deklaruar se: *e gjithë pagesa për shkollimin e djalit E. Qato, është paguar nga babai i tij M.Q. Arsyeya që ka marrë përsipër pagesën ka të bëjë me qenien e nipit të parë në familje.*

Ka dorëzuar:

- Deklaratë Noteriale nr. *** rep, nr. *** kol, dt. 30.06.2023, nga M.Q, ku është deklaruar se ka financuar duke kryer të gjitha pagesat e shkollimit të nipit të tij E. Qato, në Kolegjin "****", nga viti 2016 deri në vitin 2023. Këtë e ka bërë, pasi është nipi i tij i parë dhe e ka rritur vetë. Pagesat janë kryer nga të ardhurat që përfiton nga dhënia me qira e një pasurie pronë e tij e regjistruar me nr. pasurie 7/****, ZK 8310, vol. ***, fq. ***, me adresë në qytetin e Tiranës, ku është bashkëpronar. Pagesat fillimisht janë kryer prej tij në zyrën e financës së Kolegjit dhe më pas, ja ka dhënë djalit të tij Altin Qato për ti kryer ai pagesat.

- Vërtetim nr. *** prot., dt. 29.06.2023, nga ISSH, ku vërtetohet se L.Q. trajtohet me pension pleqërie, me masë aktuale 29.854 lekë. Të ardhurat për periudhën 11.03.2003 - 01.04.2008 janë në total 879.723 lekë.
- Vërtetim nga ISSH, për të ardhurat e përfituara nga L.Q, për periudhën 01.01.1998 - mars 2003. Të ardhurat për periudhën tetor 1998 - mars 2003, në shumën neto 733.101 lekë.
- Vërtetim nr. *** prot., dt. 22.06.2023, nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, Drejtoria Rajonale Berat, ku konfirmohen të ardhurat nga paga e. Qato për periudhën 16.10.2003 - 30.9.2005, në shumën neto 1.005.721 lekë.
- Vërtetim nr. *** Prot., datë 26.03.2023 nga QSUT, Tiranë, ku vërtetohet të ardhurat për E.Q, për periudhën nga 01.10.2005 deri më 09.05.2009, në shumën totale 925.657 lekë. Për periudhën 01.10.2005 – 01.04.2008, në shumën 597.552 lekë.

❖ **Hetimi i kryer nga Trupa Vlerësuese:**

72. Trupa Vlerësuese me e-mailin e datës 29.09.2023 drejtuar subjektit të vlerësimit ka kërkuar informacion shtesë për sa i përket të ardhurave nga qiraja dhe të specifikohet se sa nga shuma e përgjithshme e qerasë mujore ka përfituruar z. M.Q dhe sa z. E.B. Subjekti në kthim përgjigjen e tij të protokolluar me tonën nr. *** prot., datë 09.10.2023 sqaron se: *Në pasurinë me nr. 7/***, im atë është zotërues i 1² së kësaj pasurie. Për kontratat e qerasë që kërkohen shpjegime, im atë ka përfituruar 50% të vlerës së qerasë.*
73. Trupa Vlerësuese pranë AMP pasi bëri një analizë të detajuar të dokumentacionit në dosje si edhe nga shpjegimet e dhëna nga subjekti arrin në konkluzion se:
- ✓ Të ardhurat nga qiradhënia e dyqanit në b/pronësi të babait të subjektit, shtetasit M.Q, për periudhën 2007 - 2023, referuar kontratave të paraqitura, rezultojnë rreth 7.394.000 lekë + 18.600 euro (pjesa takuese).
 - ✓ Shpenzimet e deklaruara dhe të dokumentuara për arsimimin e fëmijëve, gjatë periudhës 2016 deri në ditën e plotësimit të formularit të deklarimit të pasurisë, rezultojnë në total rreth 51.506 euro, nga të cilat shpenzimet për djalin E. Qato në shumën 25.581 euro janë paguar nga babai i subjektit, nga të ardhurat e përfituara nga qiradhënia e dyqanit në pronësinë e tij.
 - ✓ Shpenzimet e deklaruara për shkollimin e djalit P. Qato i cili ndjek arsimin jo-publik në Kolegjin “****” sipas vërtetimit të këtij institucioni me nr. *** datë 06.03.2023 për periudhën 2016-2022 janë në shumën 25.925 euro.
 - **Referuar analizës financiare të kryer nga Trupa Vlerësuese pranë A.M.P rezulton se subjekti i vlerësimit ka patur mundësi financiare me burime të ligjshme për arsimimin e djalit të tij P. Qato në kolegjin “****” në shumën 25.925 euro.**
 - **Trupa vlerësuese arrin në konkluzion se personi i lidhur M.Q, babai i subjektit të vlerësimit ka patur mundësi financiare për të financuar shkollimin e nipit të tij E. Qato në shumën prej 25.581 euro.**
74. Për udhëtimet private, personale apo të personave të lidhur jashtë territorit shqiptar gjatë 3 viteve të fundit (kalendarike), duke specifikuar shtetin, vendin e qëndrimit, kohëzgjatjen dhe shpenzimet e përballuara.
Periudha 01.01.2020 - 31.12.2022.
- ✓ Shpenzime udhëtimi familjar (Kosovë) dt. 22.06.2019 - 23.06.2019, afërsisht 150 euro, (Akomodimi 30 euro dhe ushqimi 120 euro).

- ✓ Shpenzime udhëtimi familjar (Maqedoni), 31.12.2019 - 02.01.2020, Akomodim dhe ushqim afërsisht 300 euro.
- ✓ Vizitë studimore në Lisbonë Portugali, 18.09.2022 - 24.09.2022. Paguar nga Projekti Suedez për Policimin në Komunitet.
- ✓ Udhëtim bashkëshortja (Mekë) 27.06.2022 - 15.07.2022, shuma 500.000 lekë. Burimi i krijimit: Tërheqje fondesh nga llogaria në emër të E. Qato, në Tirana Bank, me datë 08.06.2022.

Bashkëlidhur deklaratës:

- ✓ Raport nga sistemi TIMS, për personin Altin Qato. Konfirmohen 4 hyrje-dalje për periudhën 2019 - 2022 dhe konkretisht 2 hyrje-dalje për vitin 2019, në datat 22.06.2019 dhe 22.08.2019 - 23.08.2019, nga pika kufitare Qafë Morinë, 1 hyrje në dt. 02.01.2020 (pa makinë - me këmbë) nga pika kufitare Qafë Thanë dhe një hyrje-dalje në datat 18.09.2022 - 24.09.2022, nga Komisariati Rinas.
 - ✓ Urdhër nr. ***, dt. 06.09.2022, nga DPPSH, për dërgimin me shërbim jashtë shtetit, për një vizitë studimore në Portugali, në datat 19 - 23.09.2022. Shpenzimet do të mbulohen nga pala organizatore.
 - ✓ Raport nga sistemi TIMS, për personin E. Qato. Konfirmohen 4 hyrje-dalje për periudhën 2019 - 2022 dhe konkretisht 2 hyrje-dalje për vitin 2019, në datat 22.06.2019 dhe 22.08.2019 - 23.08.2019, nga pika kufitare Qafë Morinë, 1 hyrje-dalje në dt. 31.12.2019 - 20.01.2020 (pa makinë - me këmbë) nga pika kufitare Qafë Thanë dhe 1 hyrje-dalje në datat 27.06.2022 - 16.07.2022, nga Komisariati i Policisë Rinas.
 - ✓ Faturë tërheqje nga Tirana Bank nga llogaria E. Qato, në dt.08.06.2022, shuma 500.000 lekë.
 - ✓ Raport nga sistemi TIMS për personin E. Qato. Konfirmohen 3 hyrje-dalje për periudhën 2019 - 2021 dhe konkretisht 1 hyrje për vitin 2019, në datën 23.08.2019, nga pika kufitare Qafë Morinë, 1 hyrje-dalje në dt. 31.12.2019 - 02.01.2020 (pa makinë- me këmbë) nga pika kufitare Qafë Thanë dhe një dalje në datën 19.11.2021, me autobus, nga pika Kufitare Qafë Morinë.
 - ✓ Raport nga sistemi TIMS, për personin P.Qato. Konfirmohen 2 hyrje-dalje për periudhën 2019-2020 dhe konkretisht 1 hyrje ne datën 23.08.2019, nga pika kufitare Qafë Morinë, 1 hyrje-dalje në dt. 31.12.2019 - 02.01.2020 (pa makinë - me këmbë) nga pika kufitare Qafë Thanë.
75. Tirana Bank, me shkresën nr. *** prot., datë 12.05.2023, konfirmon depozitë me afat në emër të E. Qato, për periudhën shtator 2012 - shtator 2013, në shumën 100.000 lekë. Për periudhën 16.09.2013 - 16.09.2014, në shumën 300.000 lekë dhe 18.09.2014 - 08.06.2022, në shumën 500.000 lekë.
- ✓ **Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar, sa i përket hyrje-daljeve nga R.SH, gjatë periudhës 2020-2022, të subjektit dhe personave të lidhur me të.**
 - ✓ **Shpenzimet e deklaruara për udhëtimet private, personale dhe të personave të lidhur gjatë periudhës 01.01.2020 - 31.12.2022, rezultojnë në total rreth 300 euro + 500.000 lekë, konvertuar rreth 534.000 lekë.**

TË DHËNA KONFIDENCIALE:

- Blerje apartamenti në mars 2007. Kontrata nr. *** rep, nr.*** kol. Trajtuar më sipër.
- Llogari bankare në bankën Raiffeisen Bank sha (monedha lekë). Nr. llogarie 1401686***. Trajtuar më sipër.

- Llogari bankare në Raiffeisen Bank sha (monedha euro). Nr. llogarie 0002686***. Trajtuar më sipër.
- Pagesë shkollimi për E. Qato në shumën 25.581 Euro, është paguar nga babai im M.Q, sipas vërtetimit datë 27.04.2018, i Kolegjit "****" Tiranë, nga të ardhurat që përfiton nga dhënia me qira e pronës me nr. pasurie 7/****. Kontrata nr.*** rep, nr.*** kol, dt. 17.10.2007. nr.*** rep, nr. *** kol, dt. 31.05.2016. nr.*** rep, nr.*** kol, dt. 29.03.2018. nr.*** Rep, nr.*** kol, dt. 22.05.2020. Trajtuar më sipër.
- Dokument i gjendjes civile, që vërteton ndarjen nga trangu familjar, nr.***, dt. 02.04.2008. Trajtuar më sipër.
- Transfertë në Tirana Bank, me vlerë 18.500 paund, sipas vërtetimit dt. 18.04.2018, të Tirana Bank, nga shtetasi K.M, i dtl. 09.05.1965, i cili punon dhe jeton në Angli. Kjo transfertë është kryer në numrin tim të llogarisë 0100-165436-***, për t'ia dhënë vjehrrit të tij, shtetasit I.B, i cili do të kryente disa pagesa financiare, për llogari të K.M dhe për shkak të moshës së tij dhe mungesës së llogarisë bankare e kishte të vështirë të kryente veprimet bankare. Me shtetasin K.M jam mik prej vitesh, sikurse edhe me vjehrrin e tij I.B, të cilin e kam pasur fqinj nga viti 2002. Në datat 29.05.2008 dhe 03.06.2008.
- Transfertë në Tirana Bank, me vlerë 12.314 euro, sipas vërtetimit dt. 18.04.2018 i Tirana Bank, nga shtetasi E.B, i biri i shtetasit I.B, i cili do të kryente disa pagesa financiare, për llogari të shtetasit E.B dhe nuk kishte nr. llogarie bankare. Kjo transfertë është bërë në llogarinë time bankare nr.0140-165436-*** dhe për shkak të moshës së tij e kishte të vështirë të kryente ato pagesa.

		Tabele e rezultati Financiar Alin Qota																											
Burimi/Viti	1998	1999	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	Prill 2007	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	26.02.2023	2023	
Te ardhura neto nga paga apo shperblime nga marredheniet e punesimit Subjektiv	118,654	78,654	269,698	289,698	247,192	488,578	263,648	-	666,583	375,493	-	483,826	1,274,011	1,374,482	1,145,812	1,177,458	1,067,303	1,689,508	1,859,375	1,516,120	1,516,305	1,217,251	1,112,334	1,114,414	1,208,599	1,344,327	217,519	22,106,642	
Te ardhura neto nga paga apo shperblime nga marredheniet e punesimit	-	-	-	30,543	240,750	70,904	116,833	69,326	289,381	21,778	-	117,836	38,000	174,000	426,015	520,025	508,852	614,031	686,847	720,080	670,725	678,490	630,970	677,658	688,564	117,990	8,088,118		
Te ardhura neto nga qerale									100,000		150,000																	250,000	
Te ardhura neto nga pendimet dhe vlerat subjektive	295,176	213,731	375,066	390,847	412,028	563,064	1,004,464	910,163	837,771	858,805																		5,861,145	
Te ardhura nga shperblim per natyre te vecante pune																											335,175	335,175	
Te ardhura neto nga interesat bankare ne Raiffeisen Bank														35,910	48,500	55,220	55,350		3,400				293,267					492,657	
Te ardhura nga Bono thesari dhe obligacione																								37,589	18,607	31,429		67,625	
Te ardhura me vendim gjykatke largim te na dhe te nga ruma									666,583																			666,583	
Te ardhura te krijuara nga shirja e shirja e makines dt. 20.12.2018																							500,000					500,000	
Te ardhura te realizuara nga shirja e apartamenteve				2,800,000						700,000																		3,500,000	
Te ardhura te krijuara nga Fondi i Investimeve ne Raiffeisen Invest																				58,653	140,760	93,854						293,267	
Te ardhura nga Taksa e Solidaritetit		82,144	123,216																									205,360	
Totali i Ardhurave neto	413,830	374,529	767,860	3,491,088	899,970	1,132,576	1,385,045	979,489	2,438,928	2,056,076	-	633,626	1,391,647	1,412,482	1,355,722	1,652,973	1,642,559	2,253,710	2,473,406	2,295,020	2,377,155	2,481,830	2,084,091	1,782,973	1,905,894	2,399,495	335,599	42,387,572	
Detyrime: Te hyra nga huatë kred/dhurim																													
Shpenzime jeshite sipas INSTAT	240,000	240,000	432,000	374,448	374,448	374,448	374,448	442,848	442,848	314,304	785,760	409,861	546,480	546,480	546,840	584,096	584,096	679,992	697,104	940,368	970,500	1,028,868	1,107,192	1,118,700	1,119,060	1,138,608	188,788	16,963,565	
Raiffeisen Invest fondi i investimeve													700,000	300,000	200,000	300,000		500,000	630,000	360,000	240,000							3,230,000	
Krijim depozite Bashkeshtortja																300,000	200,000											500,000	
Shpenzime per Arsimimi																				351,025	482,088	461,456	398,984	545,432	502,643	475,768		3,218,406	
Shpenzime Udhetimi jashte vendit																											500,000	500,000	
Totali shpenzimeve dhe te dalave	240,000	240,000	432,000	374,448	374,448	374,448	374,448	442,848	442,848	314,304	785,760	409,861	546,480	1,246,480	846,840	784,096	1,164,096	1,079,992	1,397,104	1,941,393	1,812,568	1,730,324	1,507,176	1,664,132	1,621,703	2,114,376	188,788	24,431,971	
Investime pasuri brese shtepja				2,850,000						3,396,600		1,103,400																7,350,000	
Blerje Makine date 26.02.2007										500,000																		500,000	
Gjendje ne Banka depozitim									1,855,500												500,000							3,501,257	
Gjendje Cash																											713,600	713,600	
Totali Pasuri	-	-	-	-	2,850,000	-	-	-	1,855,500	3,896,600	-	1,103,400	-	-	-	-	-	-	-	500,000	-	-	-	-	-	-	4,214,857	14,420,357	
Mundësia për Arsimime: Te Ardhura-Detyrime-Shpenzime-Pasuri	173,830	308,359	644,338	3,760,979	1,436,501	2,194,628	3,206,228	3,741,887	3,882,447	1,727,619	941,859	62,224	845,167	1,011,169	1,520,051	2,408,928	2,887,390	4,061,108	5,137,410	4,961,037	5,526,594	6,277,100	6,854,015	6,972,858	7,257,017	7,542,136	3,473,020	3,535,244	

B. KONTROLLI I FIGURËS

76. Objekti i kontrollit të figurës është verifikimi i deklarimeve të punonjësit dhe i të dhënave të institucioneve, me qëllim verifikimin e vërtetësisë dhe besueshmërisë së deklarimeve, si dhe identifikimi i atyre që janë të përfshirë apo të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar, kanë kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë ose të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar.”

77. Analiza ligjore e raportit të vlerësimit të figurës, mbështetet në tre element:

1. Të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në deklaratën e figurës, sipas përcaktimeve të nenit 36, pika 1, ligjit nr.12/2018, i ndryshuar;
2. Raportin e hollësishëm të përgatitur nga struktura përgjegjëse pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore;
3. Verifikimin e informacioneve të ardhura nga publiku, në lidhje me aktivitetin apo veprimtarinë e punonjësit apo të personave të lidhur, në zbatim të nenit 36, pika 3, germa ë, e ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.

78. Trupa e Vlerësimit ka kryer kontrollin e figurës të subjektit të vlerësimit Z. Altin Qato, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, verifikimin e vërtetësisë dhe të besueshmërisë të deklarimeve si dhe të identifikohet nëse subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në veprimtari kriminale, sipas kushteve të parashikuara në ligjin nr. 12/2018, të ndryshuar.

79. Për kontrollin e figurës Trupa e Vlerësimit administroi:

- a. Deklaratën e Kontrollit të Figurës.
- b. Raportin e hollësishëm të përgatitur nga struktura përgjegjëse pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore.

80. Struktura përgjegjëse pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore (AMP) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit Z. Altin Qato, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikojë nëse subjekti i vlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në ligjin nr. 12/2018, të ndryshuar, ka dërguar raportin përfundimtar me shkresën nr. *** prot., datë 23.10.2023, për subjektin e vlerësimit, në përputhje me nenin 42, pika 2, të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar, dhe konstaton se:


Formulari i deklaramit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.


Për subjektin e vlerësimit Z. Altin Qato, me detyrë Drejtor, në Drejtorinë e Policisë Rrugore, në Departamentin e Sigurisë Publike, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, dhe "personave të lidhur", nuk administrohen të dhëna, fakte apo prova, që punonjësi është i përfshirë ose i dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar, apo që tregojnë se punonjësi ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë ose të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar.


Në deklaratën e Kontrollit të Figurës shtojca 1 subjekti ka deklaruar se:

 Gjeneralitetet

- Se nuk ka pasur emër apo mbiemër të tjerë më parë,
- Se nuk është njohur nga të tjerë me ndonjë nofkë, emër apo mbiemër tjetër,
- Se nuk ka pasur nënshtetësi tjetër,

 Në deklaratën për kontrollin e figurës, pjesa e dytë, shtojca 1, subjekti deklaron të dhënat përkatëse mbi vendbanimin,

 Në pjesën 3 dhe 4, të shtojcës 1, subjekti ka deklaruar të dhëna ndër vite lidhur me arsimin, kualifikimet, specializimet apo trajnimet dhe punësimin përkatës,

 Në pjesën 5, të shtojcës 1, lidhur me të dhënat e sigurisë subjekti ka deklaruar:

- Nuk është dënua ndonjëherë me vendim gjyqësor të formës së prerë nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj,
 - Ka qenë në hetim dhe gjykim nga një autoritet shqiptar ose i huaj për kryerjen e një vepr penale. *“Nga prokuroria e rrethit Gjyqësor me datë 18.05.1998 ka filluar procedimi penal për shpërdorim detyre i cili i ka kaluar Prokurorisë Ushtarake Korçë. Më datë 12.11.1998 nga Prokuroria, është vendosur pushimi i çështjes”.*
 - Nuk ka qenë ndonjëherë i ndaluar apo arrestuar nga organet ligj zbatuese shqiptare apo të huaja për kryerjen e një vepr penale.
 - Nuk ka qenë caktuar ndonjëherë masë shtrënguese e sigurisë personale, në fuqi ose jo.
 - Nuk është lëshuar asnjëherë ndaj tij një urdhër kërkimi ndërkombëtar lidhur me kryerjen e veprave penale.
 - Nuk është marrë asnjëherë masë dëbimi nga një shtet i huaj.
 - Nuk ka dijeni se ndonjë nga anëtarët e familjes së tij bashkëshorti/bashkëshortja, fëmijët, bashkëjetuesi/t si dhe personat e përfshirë në certifikatën familjare) është përfshirë në veprimtari që lidhen me krimin e organizuar.
 - Nuk ka pasur kontakte të papërshtatshme në formën e takimit, komunikimit elektronik, ose çfarëdolloj mënyre tjetër takimi i qëllimshëm, me një ose më shumë persona të përfshirë në krimin e organizuar, që nuk është në pajtim me ushtrimin e detyrës së subjektit.
 - Nuk ka pranuar/shkëmbyer para, favore, dhurata ose pasuri me një person të përfshirë në krimin e organizuar.
 - Nuk ka dijeni se një person i familjes, ka pranuar/shkëmbyer para, favore, dhurata ose pasuri me një person të përfshirë në krimin e organizuar.
 - Nuk i është refuzuar hyrja në ndonjë shtet të BE/NATO-s gjatë 10 viteve të fundit.
 - Nuk ka kërkuar azil politik në ndonjë shtet.
 - Nuk ka patur procedime penale dhe administrative, brenda dhe jashtë vendit sipas përcaktimeve të ligjit për integritetin e personave që zgjidhen emërohen ose ushtrojnë funksione publike.
 - Nuk ka fshehur apo keq prezantuar, falsifikuar një informacion të një rëndësie të madhe të një natyre sigurie të veçantë apo gënjyer gjatë plotësimit të formularit të deklaratës së kontrollit të figurës.
 - Nuk ka kryer shkelje sigurie apo të ketë nëpërkëmbur rregullat e sigurisë së informacionit të klasifikuar.
 - Nuk ka qenë asnjëherë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Ish-Sigurimi i Shtetit para vitit 1991, sipas ligjit “Mbi të drejtën e informimit me dokumentet e ish- shërbimit të sigurimit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”.
 - Nuk ka vuajtur nga çrregullime mendore kronike.
 - Nuk është përdorues i lëndëve narkotike
 - Nuk ka pasur asnjëherë varësi ndaj alkolit apo lojërave të fatit.
81. Po ashtu, subjekti ka nënshkruar edhe dy vetdeklarimet për vërtetësinë e të dhënave dhe saktësinë e tyre të paraqitura në deklaratën e kontrollit të figurës si dhe deklaratën për dhënien e pëlqimit për mbledhjen e të dhënave, kryerjen e kontrollit të figurës dhe aksesin për njohjen dhe administrimin e të dhënave personale.

❖ **Hetimi i kryer nga Trupa Vlerësuese e AMP:**

82. Për të vijuar me kontrollin tërësor të figurës dhe saktësinë e deklaramit të subjektin e vlerësimit lidhur me këtë aspekt, në bazë të nenit 36, të ligjit nr. 12/2018, datë 05.06.2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar, janë kryer veprimet e duhura nga struktura përgjegjëse pranë AMP, duke kërkuar të dhëna nga institucionet të shprehura në këtë ligj si më poshtë:

- Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile,
- Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve,
- SHISH,
- Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit,
- Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes,
- Agjencia e Mbikëqyrjes Policore,
- Prokurorisë së Përgjithshme,
- SPAK,
- DPPP,
- AKSIK,
- Avokatit të Popullit,
- Autoritetit për Informimin mbi Dosjet e ish-Sigurimit të Shtetit.

Në bazë të informacionit të dërguar nga institucionet përgjegjëse, Trupa e Vlerësimit konstatoi se:

- **Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile** me shkresën “I kufizuar” nr. *** prot., datë 31.05.2023 konfirmon se:
 - *Nuk ka ndryshime të gjeneraliteteve për subjektin e vlerësimit z. Altin Qato.*
- **Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve** me shkresën “I kufizuar” nr. *** prot., datë 19.05.2023 konfirmon se :
 - *Nuk rezulton i dënuar.*
- **Organi ligj zbatues** me shkresën “Sekret” nr. *** prot., datë 30.05.2023 bën me dije se: Pas verifikimeve të kryera për Z. Altin Qato nuk disponon të dhëna të tjera sa ju kemi informuar me shkresën nr.*** datë 27.09.2022 në përgjigje të tuajës nr.** datë 02.09.2022. Po kështu ky institucion bën me dije se për shtetasin Altin Qato ka përcjell institucionit informacionin nr.***. datë 07.12.2017. Të dhënat në ngarkim të subjektit të vlerësimit janë ndarë me institucionet e tjera ligjzbatuese të cilat kanë kryer verifikimet përkatëse ku ka rezultuar se:
 - Nuk konfirmohet vërtetësia e tyre.
 - Nuk ka fakte apo prova që subjekti është i përfshirë apo i dyshuar në përfshirje në krimin e organizuar, apo që tregojnë që ka kontakte të pa përshtatshme me persona të përfshirë ose të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar.
 - Nuk rezulton që në emër të subjektit të vlerësimit të jetë regjistruar procedim penal.
- **Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit** me shkresën “I kufizuar” nr. *** prot., datë 30.05.2023 dhe me shkresën “I paklasifikuar” nr.*** prot., datë 30.05.2023 konfirmon se:

- *Nuk ka të dhëna apo indicie për fillimin e hetimeve në lidhje me dyshimet e ngritura në kuptimin penal dhe të cenimit të figurës së subjektit, të përfshirë drejtpërdrejt ose indirekt në veprime të dyshimta.*
- *Nuk ka të dhëna për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshire në krimin e organizuar, (sipas përcaktimeve të bëra në ligjin Nr. 95/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar") ku mund të përfshihen biseda, foto vëzhgime takimesh apo kontakte telefonike, etj.;*
- *Nuk ka të dhëna për kontakte të papërshtatshme me persona të dënuar ose proceduar penalisht, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për një nga veprat e parashikuara në pikën 1, të nenit 3, të Ligjit nr. 10192, datë 03.12.2009, "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë", i ndryshuar;*
- *Nuk ka të dhëna në lidhje me hetimin ose gjykimin nga një autoritet shqiptar ose i huaj, për kryerjen e një vepre penale;*
- *Nuk ka të dhëna në lidhje nëse ka qenë i ndaluar apo i arrestuar nga organet ligjzbatuese shqiptare apo të huaja, për kryerjen e një vepre penale;*
- *Nuk ka të dhëna në lidhje me lëshimin e ndonjë urdhëri ndërkombëtar, për kryerjen e një vepre penale;*
- *Nuk ka të dhëna në lidhje me ndonjë masë dëbimi nga një shtet i huaj;*
- *Nuk ka të dhëna në lidhje nëse gjatë 10 viteve i është refuzuar hyrja në ndonjë shtet të BE/NATOS-S;*
- *Nuk ka të dhëna nëse nga subjekti është kërkuar azil politik në ndonjë shtet.*
- *Nuk ka procedim disiplinor apo masë disiplinore.*
- **Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes** me shkresën "Konfidencial" nr. *** prot., datë 31.05.2023 konfirmon se:
 - *Nuk disponon të dhëna.*
- **Nga një institucion tjetër ligj zbatues** me shkresën "Sekret" pa numër datë 13.06.2023 dhe shkresën "Sekret" nr. *** prot., datë *** si edhe me shkresën "I kufizuar" nr. *** prot., datë 26.05.2023 bën me dije se:
 - *Nuk disponohen ankesa , të dhëna ose informacione që lidhen me objektin e kërkesës.*
- **Prokuroria e Përgjithshme** me shkresën "I kufizuar" nr. *** datë 10.07.2023 konfirmon se:
 - *Nuk është nxjerrë urdhër ndalimi.*
 - *Nuk është kërkuar masë e sigurimit personal dhe nëse po, vlerësimi i tyre nga gjykata.*
 - *Nuk është marrë në cilësinë e të pandehurit apo personit nën hetim sipas përcaktimeve të nenit 34 dhe 35 të K.P.P.*
 - *Nuk ka patur regjistrim të njoftimit të veprave penale.*
 - *Nuk ka pasur raste të urdhërave ndërkombëtar të ndalimit.*
- **Nga një institucion tjetër ligj zbatues** me shkresën "I kufizuar" nr. *** prot., datë 08.06.2023 bën me dije se:
 - *Nuk rezulton të jetë regjistruar procedim penal.*
- **Prokuroria Pranë Gjykatës së shcallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë** me shkresën "E paklasifikuar" nr.*** prot., datë 11.10.2023 sqaron se: *Procedimi penal ***/2004*

është dërguar për gjykim në ngarkim të pandehurve N.GJ dhe GJ.S, ndërsa shtetasi Altin Qato nuk ka asnjë status dhe nuk ka qenë pjesë e këtij vendimi.

- **Nga një institucion tjetër ligjzbatues** me shkresën “Sekret” nr. *** prot., datë 18.05.2023 konfirmon se:
 - Nuk rezulton raportime për subjektin e vlerësimit z. Altin Qato dhe personat e tjerë të lidhur me të, përveç atyre rutinë.
 - **Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar** me shkresën “I kufizuar, nr. *** prot., datë 25.05.2023 konfirmon se :
 - Është i pajisur me Certifikatë Sigurie Personeli (CSP) niveli “Konfidencial” lëshuar me datë 10.03.2021 e vlefshme deri më datë 09.03.2026.
 - Organi ligjzbatues nuk disponon rekorde për shkelje në lidhje me informacionin e klasifikuar “Sekret Shtetëror”, të NATO, BE, shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare.
 - **Avokati i Popullit** me shkresën “E paklasifikuar” nr., *** prot., datë 30.05.2023 konfirmon se:
 - Nuk ka njoftime apo ankesa nga publiku në lidhje me veprime ose mosveprime në kundërshtim me ligjin gjatë kryerjes së detyrës.
 - Nuk ka nisje të hetimit administrativ për shkelje të kryera nga subjekti.
 - **Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit** me shkresën “I kufizuar” nr.*** prot., datë 08.06.2023 bën me dije se:
 - Nuk ka qenë në ndjekje për spiunazh, terrorizëm si dhe anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga ish-Sigurimi i shtetit deri me 02 Korrik1991.
 - **Nga një institucion tjetër ligjzbatues** me shkresën “I kufizuar” nr. *** prot., datë 28.12.2023 protokolluar me tonën nr.*** prot., datë 03.01.2024 bën me dije se:
 - Në emër të Subjektit të Vlerësimit dhe personave të lidhur me të, nuk rezulton të jetë regjistruar ndonjë procedim penal.
 - **Nga një institucion tjetër ligjzbatues** me shkresën “I kufizuar” nr.*** prot., datë 07.02.2024 protokolluar me tonën nr.*** prot., 07.02.2024 bën me dije se:
 - Nuk është regjistruar procedim penal ndaj shtetasve të lartpërmendur.
83. Pranë Trupës Vlerësuese dhe AMP , nuk janë paraqitur denoncime nga publiku ndaj subjektit të vlerësimit Altin Qato , për shkelje të rregullave të etikës në ushtrimin e detyrës si punonjës në Policinë e Shtetit, sipas parashikimit ligjor të nenin 36, pika “ë” të ligjit nr.12/2018 (i ndryshuar).

Testi për përdorim lëndësh narkotike:

84. Subjekti i vlerësimit z. Altin Qato në zbatim të pikës 2, të nenit 38, të Ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar, me shkresën nr. *** prot., datë 05.12.2023 të Institutit Mjekësisë Ligjore protokolluar me tonën nr. *** datë 06.12.2023 ka kryer testin mbi përdorimin ose jo të lëndëve narkotike. Në bazë të rezultateve të përfituara të testimit për përdorim lëndësh narkotike, konkludohet se:
- Në mostrën e urinës marrë subjektit me kod shifror ***, mbyllur në kontejner, nuk u zbulua prania e produkteve të metabolizmit të MOP (opiate/heroine), COC (cocaine), MTD (metadon), THC (canabinoide/cannabis sativa), BARB (barbiturate), TCA (tricklike antidepressante), AMP (amfetamine), MDMA. (ekstazi), LSD (acid lisergjik), BZO (benzodiazepina).

Në përfundim të hetimit të kryer:

85. Trupa vlerësuese pranë AMP pas një hetimi të kontrollit të figurës për subjektin e vlerësimit Altin Qato, nëpërmjet analizimit dhe verifikimit të dhënave të deklaruara nga subjekti i vlerësimit në formularin e deklarimit për kontrollin e figurës, analizimit dhe verifikimit të dhënave të mbledhura nga institucionet dhe agjencitë ligj zbatuese, në përputhje me dispozitat ligjore të ligjit nr.12/2018, të ndryshuar, arriti në konkluzionin se subjekti i vlerësimit Altin Qato:
- a. Ka plotësuar formularin e deklarimit për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi.
 - b. Ka informacion në deklarimin e tij dhe të konfirmuara nga institucionet përgjegjëse, të përcaktuara në këtë ligj, që tregon se subjekti ka patur një procedim penal për shpërdorim detyre në vitin 1998 dhe me datë 12.11.1998 është vendosur pushimi i çështjes. Këtë fakt e konfirmon Prokuroria e Përgjithshme e cila me shkresën nr. *** prot., datë 15.11.2023, përcjell informacionin e ardhur nga Prokuroria pranë Gjykatës Shkallës Parë Juridiksioni i Përgjithshëm Korçë me shkresën nr. *** prot., datë 08.11.2023, bashkëlidhur, Vendimi i Pushimit të çështjes nga Prokuroria pranë Gjykatës Ushtarake Shkalla e Parë Korçë nr. çështjes ***.
 - c. Procedimi penal nr.***/2004, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kurbin. Në vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin nr.*** datë 26.04.2006 në lidhje me procedimin penal ***/2004, shtetasi Altin Qato nuk ka qenë pjesë e këtij vendimi dhe në kërkesën e Prokurorisë ky shtetas nuk ka patur asnjë status.
 - d. Urdhëri Nr.***, datë 22.05.2004, i Ministrisë të Rendit Publik për përjashtim nga Policia e Shtetit, shfuqizuar me Vendim të Gjykatës së Apelit Tiranë nr. ***, datë 28.06.2006 dhe Vendim të Gjykatës së Lartë nr. ***, i vendimit (***) datë 22.11.2007, lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë.

C . VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

86. Objekt i vlerësimit të aftësive profesionale është vlerësimi i nivelit të arsimimit dhe trajnimit në përputhje me gradën dhe/ose pozicionin e subjektit të vlerësimit, respektimi i rregullave të etikës dhe i përmbushjes së detyrave nga subjekti, në përputhje me nenet 43, 44, 45, 47, të Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar dhe me legjislacionin që rregullon veprimtarinë e punonjësit të “Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore”.
87. Analiza ligjore e raportit të vlerësimit të aftësive profesionale mbështetet në dy elemente:
- a. Të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në formularin e aftësive profesionale, sipas përcaktimeve të nenit 44, pika 1, ligjit nr.12/2018, i ndryshuar,
 - b. Raportin e përgatitur nga struktura përgjegjëse e burimeve njerëzore/standardet profesionale në Policinë e Shtetit, Gardën e Republikës, Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore, sipas përcaktimeve të nenit 46, pika 2, ligjit nr.12/2018, i ndryshuar.
88. Subjekti i vlerësimit Z. Altin Qato në momentin e dorëzimit të dokumentacionit në zbatim të ligjit nr.12/2018, i ndryshuar, ka ushtruar funksionin e Drejtorit të Drejtorisë së Policisë Rrugore në Departamentin e Sigurisë Publike, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë të Shtetit.

89. Raporti për vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të vlerësimit mbështetet në informacionin dhe dokumentacionin e marrë nga DPPSH, në dokumentacionin e paraqitur nga subjekti i vlerësimit gjatë hetimit administrativ kryesisht si dhe nga burime të tjera të ligjshme për nivelin e arsimimit në përputhje me pozicionin e punës. Procesi i vlerësimit të aftësive profesionale për subjektin e vlerësimit, është kryer në përputhje me kreun V, “Vlerësimi i aftësive profesionale”, të Ligjit nr.12/2018, (i ndryshuar) bazuar në nenet 43 - 46, të po këtij ligji.
90. Vlerësimi i Aftësive Profesionale nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit për subjektin e vlerësimit Z. Altin Qato , bazuar në nenin 47, të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, me shkresën nr. *** prot., datë 30.06.2023, protokolluar me tonën nr. *** prot., datë 05.07.2023 arrin në përfundim se: *Punonjësi i policisë z. Altin M. Qato është i përshtatshëm për pozicionin e tij të punës, ka arsimin dhe trajnimet përkatëse për funksionin që mban, ka treguar cilësi të pranueshme në punë, aftësi në zbatim të detyrave sipas përshkrimeve të punës, ka respektuar liritë dhe të drejtat e njeriut, është i frytshëm dhe efektiv në masë të pranueshme duke rezultuar i kualifikuar për ta ushtruar funksionin që mban.*
91. Altin Qato është subjekt i vlerësimit të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar dhe aktualisht mban detyrën e Drejtorit të Drejtorisë së Policisë Rrugore në Departamentin e Sigurisë Publike, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, bazuar në urdhërin e emërimit, nr. ***, datë 27.10.2021, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.
- Objekti i vlerësimit të aftësive profesionale sipas përcaktimit të nenit 43, të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar, ka të bëjë me vlerësimin e nivelit të arsimimit dhe trajnimit në përputhje me gradën dhe/ose pozicionin, respektimin e rregullave të etikës, si dhe përmbushjes së detyrave nga subjekti në përputhje me legjislacionin që rregullon veprimtarinë e Policisë së Shtetit.
- Procedura për vlerësimin e aftësive profesionale kryhet bazuar në nenet 44-46, duke mbajtur në vëmendje aftësitë profesionale dhe ecurinë në karrierë të punonjësit duke respektuar legjislacionin e posaçëm që rregullon marrëdhënien e punës (në këtë rast Ligji për Policinë e Shtetit, Rregullorja e Policisë dhe aktet e tjera rregullatore e nënligjore në fuqi) si dhe në përshkrimet e punës për çdo funksion.
- Trupa Vlerësuese përdori si burime për vlerësimin e saj, fillimisht :
- Të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në formularin e Aftësive Profesionale, sipas përcaktimeve të nenit 44, pika 1, të Ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar.
 - Më tej, të dhënat nga institucionet përgjegjëse që konfirmojnë nivelin arsimor dhe kualifikimet përkatëse, ecurinë në karrierë të subjektit nga dosja e personelit dhe nga vërtetime e akte të tjera administrative të emërimeve në funksione dhe dhënies së gradave respektive, ecurinë disiplinore, vendimet e formës së prerë të gjykatave që lidhen me procese disiplinore etj. Vlerësimet e punës individuale në pesë vitet e fundit. Gjithashtu, Trupa e Vlerësimit mban në konsideratë dhe shqyrton edhe denoncimet nga publiku për sjellje jo profesionale të punonjësit, apo informacione të tjera të lidhura me ushtrimin e detyrës së tij në mënyrë jo etike.
 - Afati kohor brenda të cilit shtrihet procesi i vlerësimit të aftësive profesionale.
- Subjekti i vlerësimit Altin Qato ka dorëzuar në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, (Formularin e Vetëvlerësimit të Aftësive Profesionale), sipas përcaktimeve të nenit 44, pika 1, të Ligjit Nr. 12/2018, të ndryshuar. Periudha e vlerësimit

për aftësitë profesionale, për efekt të këtij ligji, përfshin periudhën që nga data e emërimit të punonjësit në gradën dhe/ose pozicionin që mban, por jo më shumë se 5 vjet.

Subjekti në kohën e depozitimit të formularit, mbante detyrën e Drejtorit të Drejtorisë së Policisë Rrugore në Departamentin e Sigurisë Publike, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, funksion që e mban që prej datës 27.10.2021.

VLERËSIMI I NIVELIT ARSIMOR:

92. Në formularin e Aftësive Profesionale për Vlerësimin Kalimtar subjekti ka deklaruar:

- ✓ Akademia e Rendit Publik 1989-1993 cikli 4 vjeçar Tiranë. Diplomë me nr. Regjistri ***, datë 03.07.1993.
- ✓ Fakulteti i Drejtësisë Universiteti Kristal 2005-2008. Diplomë nr. Amzës ***, datë 21.10.2008 (Cikli i parë me kohë të pjesshme).
- ✓ Fakulteti i Drejtësisë Universiteti “Kristal” - 2011 Diplomë nr. Amzës/Matrikullimi KRURDB 001***, datë 19.04.2012 (Cikli i Dytë).
- ✓ Akademia e Forcave të Armatosura - 2015 cikli 2 vjeçar Master Shkencor për Sigurinë. Nr. i Diplomës Universitare *** Nr. i Diplomës së Master Shkencor ***, datë 02.11.2015.
- ✓ Subjekti i Vlerësimit ka kryer dhe një sërë kursesh e trajnimesh për ngritjen e tij profesionale.
- Të dhënat janë të administruara në dosjen personale të subjektit të vlerësimit me nr. 15****.
- Të dhënat e administruara në sistemin e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore Sistemi RMIS me numër 9001***.
- Të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në Formularin e Aftësive Profesionale për Vlerësimin Kalimtar.
- Të dhënat e siguruar nga Drejtoria e Standardeve Profesionale mbi Performancën e Subjektit.
- Të dhënat e siguruar nga burimet e mësipërme, konfirmojnë nivelin arsimor, ecurinë në karrierë dhe gradë, trajnimet, kualifikimet dhe vlerësimet individuale të punës si edhe performancën e konstatuar gjatë kontrolleve dhe inspektimeve apo ankesave në drejtim të subjektit nga Drejtoria e Standardeve Profesionale apo institucionet e tjera mbikëqyrese.

Niveli arsimor	Institucioni ku janë ndjekur studimet	Fillimi	Përfundim	Vendi	Titulli/Diploma
4-vjecare	Akademia e Rendit Publik	1989	1993	Tiranë	Diplomë
2-vjecare	Akademia e Forcave të Armatosura	2013	2015	Tiranë	Master Shkencor për Sigurinë
Cikli Parë (Sistemi me kohë të Pjesshme)	Fakulteti Drejtësisë Universiteti “Kristal”	2005	2008	Tiranë	Diplomë

Cikli Dytë	Fakulteti Drejtësisë Universiteti "Kristal"		2011	Tiranë	Diplomë
------------	---	--	------	--------	---------

❖ **Arsyetimi ligjor i Trupës Vlerësuese:**

93. Në kuptim të legjislacionit për Policinë e Shtetit dhe në ligjin në fuqi Nr.108/2014, "Për Policinë e Shtetit", i ndryshuar, trupa e vlerësimit arrin në konkluzionin se subjekti i vlerësimit, që në kohën e emërimit në detyrë për herë të parë në Policinë e Shtetit dhe deri në vijueshmërinë e ecurisë në karrierë të tij, ka qenë në përmbushje të kriterit të nivelit arsimor.

Sipas të dhënave të administruara në dosjen personale të subjektit të vlerësimit rezultojnë se subjekti ka kryer edhe trajnime dhe specializime dhe për këtë ka marrë edhe certifikatat përkatëse. Ai u ka kushtuar rëndësi trajnimeve që kanë të bëjnë me objektin e tij të punës si dhe ka marrë pjesë në konferenca dhe Ëorkshop-e të ndryshëm.

Sipas të dhënave të administruara në dosjen personale të subjektit, rezultojnë se ai ka kryer trajnimet/specializimet si më poshtë:

Nr/Viti	Emërtimi i trajnimit	Lloji i Dokumentit
1. 2001	Kurs Kompjuteri.	Certifikatë
2. 2001	Kurs bazë për hetimin e vrasjeve.	Certifikatë
3. 2002	Seminar për Forcat e Policisë/Sigurisë mbi të Drejtat Ndërkombëtare Humanitare të Njeriut.	Certifikatë
4. 2002	Trajnimi i Trajnerëve të Policisë.	Certifikatë
5. 2009	Përpunimi dhe plotësimi i statistikave të Policisë së Shtetit.	Certifikatë
6. 2010	Ylli dhe Komanda e Policisë Kosovë.	
7. 2010	Rritja e Kapaciteteve dhe vendosja e urave të Ndërveprimit midis Institucioneve të qeverisë lokale.	
8. 2011	Shoqata Mbrojtja e të Drejtave të Gruas Q.e.Fsh BERAT	

94. Në dosjen personale të subjektit për periudhën 2018-2023 rezultojnë se janë administruar 4 (katër) vlerësime pune, një mungon.

Agjencia e Mbikëqyrjes Policore me shkresën Nr.***, datë 14.07.2023, kërkon të dhëna shtesë DPPSH, për procesin e vlerësimit kalimtar për subjekti z. Altin Qato. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit me shkresën Nr.*** datë 21.07.2023 konfirmon se për subjektin e vlerësimit Z. Altin Qato në lidhje me vlerësimin e punës për periudhën 01.01.2018 deri më 31.12.2018 nuk ka të administruar në dosje vlerësim pune për këtë periudhë.

Subjektit të vlerësimit me e-mailin e datës 27.09.2023 i është kërkuar të japë një shpjegim për mungesën e këtij formulari (vlerësim pune), dhe me shkresën *** prot., datë 09.10.2023, subjekti e konfirmon vlerësimin e punës për vitin 2018 me 28 pikë dhe e shoqëron me formularin përkatës.

Për periudhën 2018-2022 është vlerësuar si vijon:

- Vlerësim i rezultateve të punës për vitin 2018 28 pikë (shumë mirë)
- Vlerësim i rezultateve të punës për vitin 2019 28 pikë (shumë mirë)
- Vlerësim i rezultateve të punës për vitin 2020 28 pikë (shumë mirë)

- d. Vlerësim i rezultateve të punës për vitin 2021 28 pikë (shumë mirë)
- e. Vlerësim i rezultateve të punës për vitin 2022 95 pikë (shumë mirë)

Për periudhën e fundit 5(pesë) vjeçare 2018-2023 të përcaktuar në pikën 2, të nenit 44, të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar subjekti i vlerësimit nuk është ndëshkuar disiplinisht me masë disiplinore.

❖ **Konkluzion i Trupës Vlerësuese:**

- 95. Bazuar në vlerësimet e mësipërme trupa vlerësuese arrin në konkluzion se subjekti i vlerësimit ka përmbushur detyrat funksionale, respektuar rregullat e etikës si edhe ka shfaqur performancë të lartë në kryerjen e detyrave funksionale.

Subjekti i vlerësimit Z. Qato ka një karrierë në Policinë e Shtetit prej 26 vite e 5 muaj, dhe në 5(pesë) vitet e fundit që është edhe objekt deklarimit ka ketë ecuri në karrierë:

- ✓ 01.06.2017 deri 15.02.2018 Drejtor i Departamentit për sigurinë Publike.
- ✓ 16.02.2018 deri 14.04.2019 Drejtor i Drejtorisë Vendore të Policisë Elbasan.
- ✓ 15.04.2019 deri 27.10.2021 Përgjegjës i Departamentit të Hetimit të Krimit në Akademinë e Sigurisë.
- ✓ 01.11.2021 e në Vazhdim: Drejtor i Policisë Rrugore.

Ecuria në Gradë e Subjektit të Vlerësimit Z. Altin Qato:

- i. Me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit Nr.***, datë 14.11.2012, “Për ngritje në gradë të një punonjësi policie “K/Komisar” z. Altin Qato i cili është shpaluar fitues në konkurimin për gradën policore “Drejtues”, përfundon kursin e barasvlershëm/ekuivalent me shkollimin për nivelin e mesëm drejtues, i jepet grada policore “Drejtues”.
- ii. Me urdhër të Ministrit të Punëve të Brendshme Nr. ***, datë 09.10.2013 “Emërim në detyrë të një punonjësi policie”, Drejtues Altin Qato emërohet në detyrën e Zv/ Drejtor i Përgjithshëm për Sigurinë Publike në Departamentin për Sigurinë Publike në DPPSH, dhe i jepet grada policore “Zëvendës drejtor i Përgjithshëm”.
- iii. Me urdhër të Ministrit të Punëve të Brendshme Nr. ***, datë 19.05.2015 “Për emërim në detyrë dhe dhënie e gradës “Drejtues i Lartë” një punonjësi policie” Zëvendës drejtor i Përgjithshëm Z. Altin Qato emërohet në detyrën “Drejtor i Përgjithshëm për Sigurinë Publike në Drejtorinë e Përgjithshme për Sigurinë Publike në DPPSH, dhe i jepet grada policore “Drejtues i Lartë”.
- iv. Me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit Nr. *** Datë 15.02.2018 “Për dhënien e gradës policore, ndërprerjen e transferimit të përkohshëm dhe emërim në detyrë të një punonjësi policie Drejtues i Lartë Altin Qato i liruar nga detyra Drejtor i Departamentit në Departamentin e Sigurisë në DPPSH, me urdhërin nr.*** datë 14.02.2018 të Ministrit të Brendshëm transferohet në një detyrë tjetër dhe i jepet grada policore “Drejtues i Parë”. Gradë të cilën e mban dhe aktualisht.

❖ **Hetimi i kryer nga Trupa Vlerësuese pranë AMP:**

- 96. Nga shqyrtimit i dokumentacionit në dosjen e subjektit me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm nr. *** datë 14.11.2012 “Për ngritje në gradë të një punonjësi policie” bazuar në nenin 42 pika 1 dhe 2, shkronja “b” e ligjit nr. 9749 datë 04.06.2007, “K/Komisar” Altin Qato pasi ka përfunduar kursin e trajnimit për gradë, i jepet grada policore “Drejtues”.

Në dosjen e subjektit të vlerësimit gjendet urdhëri i Ministrit të Punëve të Brendshme nr. *** datë 09.10.2013 “Për ngritje në detyrë të një punonjësi policie” bazuar në nenin 23, pika 2 e ligjit nr. 9749, datë 04.06.2007, “Drejtues” Altin Qato pasi ka përfunduar kursin e trajnimit për gradë, i jepet grada policore “Zëvendës drejtor i Përgjithshëm”.

Me urdhër të Ministrit të Punëve të Brendshme Nr. ***, datë 19.05.2015 “Për emërim në detyrë dhe dhënie e gradës “Drejtues i Lartë” një punonjësi policie”, Zëvendës drejtor i Përgjithshëm Z. Altin Qato emërohet në detyrën “Drejtor i Përgjithshëm për Sigurinë Publike” në Drejtorinë e Përgjithshme për Sigurinë Publike në DPPSH, dhe i jepet grada policore “Drejtues i Lartë”. Me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit Nr. *** datë 15.02.2018, “Për dhënien e gradës policore, ndërprerjen e transferimit të përkohshëm dhe emërim në detyrë të një punonjësi policie Drejtues i Lartë Altin Qato i liruar nga detyra Drejtor i Departamentit në Departamentin e Sigurisë në DPPSH, me urdhërin nr. *** datë 14.02.2018, të Ministrit të Brendshëm transferohet në një detyrë tjetër dhe i jepet grada policore “Drejtues i Parë”. Gradë të cilën e mban dhe aktualisht.

Emërtimi Gradës	Arsyeja e ndryshimit	Nr. Urdhrit	Data	
				Deri
Drejtues	Ngritur në gradë	Nr.*** dt. 14-11-2012	15-10-2012	08-10-2013
Zv/Drejtor i Përgjithshëm	Emëruar në detyrën Zv/Drejtor i Përgjithshëm	Nr. *** dt. 09-10-2013	09-10-2013	18-05-2015
Drejtues i parë	Emëruar në detyrën Drejtor Përgjithshëm për Sigurinë Publike	Nr.*** dt. 19-05-2015	19-05-2015	15-02-2018
Drejtues i parë	Liruar nga detyra e Drejtorit të Departamentit	Nr. *** dt. 15-02-2018	16-02-2018	

❖ **Konkluzioni Trupës Vlerësuese:**

97. Në lidhje me ecurinë në gradë dhe në karrierë të Subjektit të Vlerësimit Z. Altin Qato trupa vlerësuese arrin në konkluzion se funksionet në të cilat është emëruar subjekti si edhe gradat që ai ka përfutuar gjatë karrierës së tij rezultojnë në përputhje dhe në zbatim me legjislacionin rregullator të kohës, ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi.

Në përfundim të vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit Z. Altin Qato, bazuar në të dhënat e disponueshme të administruara në dosjen personale, sistemin RMIS, si dhe deklaratimet e vetë subjektit në dokumentacionin e dorëzuar në momentin e deklaratimit, në mbështetje të nenit 47, të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, arrijmë në përfundimin se:

Subjekti i Vlerësimit Z. Altin Qato është i përshtatshëm për pozicionin e tij të punës, ka arsimin dhe trajnimet përkatëse për funksionin që mban, ka treguar cilësi të pranueshme në punë, aftësi në zbatim të detyrave sipas përshkrimeve të punës, është i frytshëm dhe efektiv në masë të pranueshme duke rezultuar i kualifikuar për ta ushtruar funksionin që mban.

KONKLUZIONI PËRFUNDIMTAR

Trupa Vlerësuese e AMP, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoi subjektin e vlerësimit në seancë dëgjimore publike datë 07.03.2024, si dhe mori në shqyrtim të gjitha shpjegimet nga subjekti i vlerësimit, arrin në përfundimin se subjekti i vlerësimit z. Altin Qato në përputhje me nenin 60, të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar, ka plotësuar së bashku kushtet e mëposhtme:

- Konstatohet nivel i besueshëm në vlerësimin e pasurisë,
- Konstatohet nivel i besueshëm në vlerësimin e kontrollit të figurës,
- Konstatohet nivel i mjaftueshëm në vlerësimin e aftësive profesionale.

PËR KËTO ARSYE

Trupa e Vlerësimit e AMP , bazuar në pikën 7, të nenit 56, të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në bazë të germës “a”, të nenit 59, si dhe të pikës 1 dhe 2 të nenit 60, të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar:

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të vlerësimit, Z. **Altin Mehmet Qato**, me funksion Drejtor në Drejtorinë e Policisë Rrugore në Departamentin e Sigurisë Publike, pranë Drejtorisë Përgjithshme të Policisë së Shtetit.
2. Vendimi i arsyetuar me shkrim i njoftohet subjektit të vlerësimit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, brenda 15 ditëve, nga dita e nesërme e shpalljes së vendimit.
3. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore në përputhje me pikën 8, të nenit 56, të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankim brenda 45 ditëve nga data e njoftimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Ky vendim u shpall në Tiranë, më datë **11.04.2024**

TRUPA E VLERËSIMIT

Kryesuese

Suela Bulku

Relator
Arben Sefaj

Anëtare
Denisa Sina